



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 20.02.20	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-3310	✓

Raporti vjetor 2019

Ekzekutivi i Komunës

Tel 038 200 46400

Rr. Qamil Ilazi 71000, Kaçanik

www.kk.rks-gov.net/kacanik

Përmbajtja

FJALA E KRYETARIT	iii
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	1
Qendra për Shërbime me Qytetar	1
Zyra komunale e gjendjes civile	2
Arkivi	3
Njësia komunale për të drejtat e njeriut	4
Mirëmbajtja e objektit	5
Autoparku	5
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	7
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	9
Inspektori Sanitar	9
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	12
Qendra për Punë Sociale	17
DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	20
Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor	20
Ngritja e cilësisë, zbatimi i plan-programit mësimor, përgatitja e dosjeve (portofolio) me shkrim e mësimdhënësve për orë mësimore	20
Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë	21
Funksionimi i organeve të shkollës: Këshilli Drejtues i Shkollës, Aktivitet Profesional, Koordinatorët e cilësisë dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos regjistrimit	21
Zhvillimi i aktiviteteve shkollore e jashtë mësimore	22
Investimet në objektet shkollore	24
Përmirësimi i aktiviteteve rinore	25
Organizimi i aktiviteteve kulturore	25
Organizimi i aktiviteteve sportive	25
DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT	27
Sektori i Financave	27

Buxheti	27
Sektori i Tatimit të Pronës	32
Sektori i Zhvillimit Ekonomik	34
Inspektoriati i Tregut	37
DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	39
DREJTORIA E EMERGJENCAVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE	42
Infrastruktura rrugore	42
Ujësjiellësi	45
Kanalizimet	45
Ujërat sipërfaqësore	46
Menaxhimi i Mbeturinave	47
Komunikacioni Rrugor	47
Hapësirat Publike	48
Ndriçimi Publik	49
Mirëmbajtja e rrugëve lokale	51
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	53
Shqyrtimi i kërkesave, mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti komunës	53
Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale	54
Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ- ve	54
Mbrojtja e pyjeve nga prerja ilegale	55
Monitorimi i operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore	56

FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetar të Komunës së Kaçanikut dhe më gjerë,

Jam zotuar si kryetar i komunës, se do t'i qojmë proceset përpara së bashku, në mënyrë që të arrijmë zhvillimin e duhur në të gjitha sferat lokale, duke përfshirë projektet kapitale, infrastrukturën dhe shërbimet efikase administrative. Në këtë kontekst, raporti në vazhdim paraqet punën tonë njëvjeçare, e arritur me shumë mund, djersë e përkushtim të jashtëzakonshëm të të gjithë stafit civil e politik. Ofrimi i shërbimeve të duhura komunale si dhe lehtësimi i mënyrës së jetesës për bashkëqytetarët tanë, duke iu mundësuar atyre infrastrukturë moderne, ishin misioni ynë për këtë vit. Ndër tjerash, puna jonë e pasqyruar më poshtë, është vetëm një pjesë e asaj se çka synojmë të arrijmë në nëpërmjet programit tonë qeverisës, që si epiqendër ka qytetarin dhe të drejtat e tij për një të ardhme prosperuese.

Në fillim të çdo viti, bashkërisht caktojmë objektivat drejtorive varësisht nga dikasteri të cilin operojnë. Duke analizuar të arriturat tona, është konstatuar që këto objektiva janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme, me shpresën që viti 2020 do të jetë edhe më i mirë.

Të arriturat tona më të mëdha vlerësohen të jenë përmbyllja e investimeve kapitale, përfitimi i grantit të performancës si dhe ngritja dhe modernizimi i shërbimeve administrative të cilat do të shtjellohen në vazhdim të këtij raporti.

Programi ynë qeverisës është shtrirë në formën ku të gjitha fushat të cilat janë kompetencë e komunës, të avancohen tutje dhe gradualisht të arrihet zhvillimi të cilin gjithsecili e pret, nisur nga projektet më të thjeshta e deri tek synimi i aplikimit të direktivave të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.

Pushteti lokal vazhdimisht përballet me sfida nga më të ndryshmet, mirëpo ne kemi vendosur standard të ri në politik-bërjen kosovare, që integriteti i lartë moral e personal, na prinë përpara drejt eliminimit të vështirësive bashkë me të gjithë akterët tjerë në Komunën e Kaçanikut.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

Z. Besim Ilazi



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Qendra për Shërbime me Qytetar

Objektivat kryesore për vitin 2019 kanë qenë reformimi dhe ngritja e efikasitetit në qendrën për shërbime me qytetar. Ndërkohë, duke u nisur nga këto objektiva, kemi përfunduar dhe implementuar sistemin e menaxhimit të radhës. Ky sistem, për shkak të vonesave në procedura të prokurimit publik, është implementuar në gjysmën e dytë të vitit 2019. Megjithatë, efektshmëria më e lartë e këtij sistemi pritet të jetë në vitin 2020. Në këtë kontekst, është arritur që të përmirësohen shërbimet tona ndaj qytetarëve, duke ulur pritjen pranë sporteleve si dhe orientimin e palëve në mënyrën e duhur. Sfidë dhe obligim i vazhdueshëm për ne mbetet rritja e llogaridhënies dhe transparencës ndaj qytetarëve si dhe modernizimi i administratës duke digjitalizuar vazhdimisht shërbimet tona. Kjo qendër, synimin kryesor përveç tjerash, ka pasur kategorizimin e shërbimeve dhe ndarjen e kërkesave në formën e duhur, duke u përkujdesur që çdo shkresë të arrijë në vendin e duhur në afate optimale.

Gjatë periudhës njëvjeçare kemi arritur që konform këtyre objektivave që përmendëm më lartë, t'i pranojmë dhe procedojmë 41122 lëndë (Tab. 1.), prej këtyre 1100 në proces të cilat presin zgjidhje konform afateve dhe ligjeve të aplikuara në Republikën e Kosovës.

Përshkrimi	Pranuar	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Përfunduar	Totali
Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	31	4	3704	12	19236	22997
Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës	33	430	1154	178	0	1805
Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	18	0	944	158	0	1129
Drejtorja e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit	13	205	6484	11	0	6726
Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	12	27	170	14	0	236
Drejtorja e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	20	0	436	37	0	496
Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	28	400	5824	10	0	6288
Shërbimi i Kryetarit	60	34	1124	200	0	1445
	215	1100	19840	620	19236	41122

Tab 1. Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes prej 01/01/2019 – 31/12/2019.

Zyra komunale e gjendjes civile

Në kuadër të drejtorisë së administratës së përgjithshme funksionon edhe sektori i ofiqarisë, konkretisht Zyra Komunale e Gjendjes Civile. Ky sektor, vlerësohet të jetë njeri ndër më të rëndësishmit në organogramin komunal. Gjendja civile ndër tjerash, është faktori kryesor që shërben si urë lidhëse në frymën e bashkëpunimit të ngushtë me ministritë përkatëse, siç janë: MPB, MAP, MAPL si dhe departamenteve që operojnë në këto ministri.

Gjatë kësaj periudhe, kjo zyrë ka vazhduar dhe po vazhdon të përballet me kërkesa nga më të ndryshmet të cilat janë mjaft të ndjeshme për nga natyra e tyre. Megjithatë, ne kemi arritur që të menaxhojmë me këto kërkesa dhe ti procedojmë për më tutje atëherë kur rregullat kanë kërkuar ashtu.

Numri i certifikatave të lëshuara nga Zyra Komunale e Gjendjes Civile kapin shifrën 35444. Ndërkohë, janë marrë gjithsej 152 vendime (ndryshime, korrigjime RTHL, RTHM, regjistrime të mëvonshme, refuzime të kërkesave etj.).

Përshkrimi	Copë
Ekstrakte të Lindjes	15977
Certifikata të Lindjes	6416
Certifikata e Martesës	4227
Certifikata e Vdekjes	1241
Certifikata e Gjendjes Martesore	814
Deklarata Familjare	3678
Certifikata e Vendbanimit	1297
Certifikata e Shtetësisë	517
Vërtetime të Arkivit	1199
Dëshmi Vdekje	78
Totali: 35295	

Tab 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2019-31/12/2019.

Përveç certifikatave, janë bërë 122 regjistrime të lindjes të veçanta dhe 9 të rregullta, 332 kurorëzime si dhe 34 kurorëzime speciale, 101 regjistrime të rregullt të vdekjes dhe 13 speciale. 62 lëndë të kompletuara për tërheqjen e shtetësisë dhe 13 lëndë për fitim të shtetësisë. Shërbimi i ofiqarisë në zyret e gjendjes civile në fshatrat Doganaj, Dubravë dhe Kaçanik i Vjetër, është ndërprerë në fillimin e muajit shtator. Pasojë e kësaj ndërprerje ishte mungesa e rrjetit qeveritar si dhe pamundësisë se organeve qendrore për të gjetur zgjidhje, sepse është kompetence e MPB që të shtrijë dhe menaxhojë rrjetin qeveritar. Ne

i kemi adresuar me kohë kërkesat dhe shqetësimet të cilat na kanë preokupuar lidhur me çështjen e mungesës së rrjetit, mirëpo për shkaqe të procedurave të prokurimit publik (sipas MPB-së), nuk na është mundësuar furnizimi normal me rrjet.

Meqenëse është analizuar nga drejtorja e administratës se kjo çështje po merr kohë, është vendosur që zyrtarët e gjendjes civile, së bashku me librat amë, të transferohen përkohësisht në objektin e komunës së Kaçanikut, me qëllim që qytetarët mos të kenë pengesë në furnizim me certifikata të nevojshme për ta dhe rrjedhimisht, shërbimet të cilat ofrohen në fshatrat e lartpërmendura, delegohen në qendër.

Arkivi

Si pasqyrim vjetor i punës të sektorit të arkivit, është bërë punimi dhe hartimi i Librit Arkivor në mënyrë Elektronike si në vijim: Kuvendi Komunal 1959 - mars 1999; Shtëpia e Shëndetit 1956-1997; Eksproprijimet 1960-1998; BVI-ja e Banimit 1969-1993; Projektet Individuale 1965-1998; Lokalet afariste 1974-1998; Sektori i ofiqarisë 1949- mars 1999; Organizata punuese "Saniteks" 1987-1991; Këshilli i Vetëfinancimit 1992-1998; Bordi Drejtorëve 2001-2008. Gjithashtu është punuar në drejtim të rregullimit ,klasifikimit ,sistemimit dhe regjistrimit të lëndëve arkivore sipas viteve ku përfshihet DAK- nga 2000-2007.

Është bërë shqyrtimi i kërkesave, llogaritja e stazhit pensional, plotësimin e formularit M4 dhe vërtetime të ndryshme si dhe janë arkivuar në formë elektronike gjithsej: **20639 lëndë**. Sipas kërkesave të zyrtarëve komunal dhe palëve, kemi bërë hulumtimin për gjetjen e dokumentacioneve të kërkuara dhe kthimin e tyre në vendin përkatës.

Jemi angazhuar me rregullimin, sistemimin ,klasifikimin, regjistrimin dhe vendosjen në rafta të projekteve shoqërore prej vitit 1958-1999, si: objekti administrativ i komunës, shtëpisë së shëndetit, D.P. Brendshme, Shkollave, Shtëpisë së Kulturës, Gjykatës, Ndërtesave Shoqërore, Projekte të Rrugëve, Urave, Përroshave, BVI-ja për pushim dhe rekreacion, Plani Detal Urbanistik, Lagjes Dushkaja, Stacioni i Veterinarisë, Qendra Zejtare, Rrjeti Kabllor PTT, Stacioni i Autobusëve, Elektrifikimeve, Zona doganore Hani Elezit dhe Gllloboçicë, Organizatave punues: "Interier", "Saniteks", "Lepenci", "Ina Oki", "Kosovaplast", "Sharr" Hani i Elezit, Projekte të Xhamive , Rregullimin, klasifikimin dhe sistemimin e fletave poseduese me një sasi të konsiderueshme

(Drejtoria për Kadastër) etj. Është bërë asgjësimi i dokumentacionit të cilit i ka kaluar afati dhe si e tillë nuk e ka cilësinë e lëndës arkivore si në vijim: Libra të postës, të thirrjeve, inventarit, materialit shpenzues, ndihmat momentale, libra të zbrazëta etj. Nga drejtoritë e Komunës dhe përfaqësuesit ligjor janë parashtruar 153 kërkesa verbale për gjetjen e lëndëve dhe projekteve arkivore, të njejtat janë kthyer duke i vendosur në vendin përkatës. Nga palët janë parashtruar: **174 kërkesa**, prej tyre **21** për vërtetime dhe llogaritje të stazhit pensional të punës (plotësimi i formularit **M4**). Palëve të interesuara ju kemi dhënë udhëzime profesionale konform Ligjit për Arkivat dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Në kuadër të DAP, funksionon edhe njësia komunale për të drejtat e njeriut. Gjatë vitit 2019, aktivitetet kryesore të kësaj njësie ishin si në vijim:

Përcjellja e punës dhe aktiviteve të seancave të kuvendit dhe komiteteve të cilat veprimtarinë e tyre duhet ta harmonizojnë me ligjet vendore dhe ndërkombëtare.

Monitorimi i intervistave gjatë pranimit të punëtoreve në përgjithësi të shërbyesve civil dhe në arsim, me qëllimin kryesor që të parandalohet shkelja e të drejtave të kandidatëve si dhe barazia për të gjithë.

Ndër tjerash, janë organizuar mbledhje, seminare, trajnime, debate, tryeza të rrumbullakëta në ngritjen e kapaciteteve vetëdijesimit të gruas në lidhje me ligjin dhe të drejtat që kanë.

Kjo zyrë, funksionon edhe në kuptimin e ruajtjes së të drejtave në përfaqësimin e barazisë gjinore e që nëpërmjet zyrtarit përkatës, janë zhvilluar shumë aktivitete.

Ndër aktivitetet kryesore janë: Dy ligjërata me temën “regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve” në fshatrat Bob dhe Kovaçec, vizitë grave nëpër të gjitha institucionet të cilat veprojnë në komunën tonë. Mbledhje, seminare, trajnime, debate, tryeza të rrumbullakëta në ngritjen e kapaciteteve vetëdijësuese.

Mbledhja e statistikave të rasteve të dhunës në familje dhe trajtimi i rasteve nga institucionet përkatëse, ligjërata vetëdijësuese me nxënësit e shkollave të mesme, ligjërata në shkollën fillore “Emin Duraku” me temën “Infrastruktura ligjore e në çështjen e barazisë gjinore, dhuna në familje, dukuritë negative në shoqërinë tonë etj.”.

Pjesë e punës së përditshme ka qenë edhe takimi i përjavshëm me të dërguarin e avokatit të popullit ku është diskutuar vazhdimisht me problemet dhe sfidat të cilat përballen shoqëria kosovare. Nga këto takime ndër tjerash, është ngritur problemi i

qytetares Marica Zhivkoviç nga fshati Soponicë, e cila si pasojë e identitetit të dyfishtë ka mbetur pa u regjistruar në librat e gjendjes civile dhe rrjedhimisht nuk mund të përfitoj nga skemat sociale. Ky rast është në procedurë gjyqësore dhe zyra për të drejtat e njeriut nuk mund të interferojë.

Mirëmbajtja e objektit

Në vazhdim të investime me qëllim të përmirësimit të kushteve në objekt, gjatë vitit 2019, kemi implementuar projektin për shkrimin e laminatit nëpër zyrë në katin e katërt. Ky projekt qëllimin kryesor e ka pasur mënjanimin e erës së rëndë që mbanin tepihët e vjetër të cilët vlerësoheshin mjaft të rrezikshëm për shëndetin e zyrtarëve të cilët punonin në ato zyrë. Njëkohësisht janë investuar në karrige, tavolina pune dhe pajisje tjera të cilat ndikojnë direkt në mirëqenien e zyrtarëve publik në ushtrimin e detyrave të punës së përditshme.

Është aplikuar pastrimi sistematik i depos, ku janë liru hapësira si dhe janë mënjeluar mbetje të papërdorshme si dhe në kuptimin e funksionimit të mirëfillt të objektit të komunës, gjatë gjithë vitit është intervenuar në shumë aspekte për rregullimin e defekteve të cilat paraqiteshin kohë pas kohe.

Shërbimi logjistik i komunës duke përfshirë edhe zyrtarin e pranimit të mallit, ka arritur që me kohë t'i shpërndaj mallrat dhe shërbimet në mënyrë efikase.

Autoparku

Për nga funksionimi i duhur i logjistikës të komunës, sektori i autoparkut është kryesori. Rëndësia e saj dëshmohet se për t'i mbikëqyrur projektet kapitale, duhet që menaxherët të përcjellin ata nga afër dhe kështu eliminohet mundësia që këto projekte kapitale të cilat i menaxhon komuna të dalin jashtë kontrollit.

Për vitin të cilën raportojmë janë përmbushur të gjitha kërkesat për udhëtime brenda territorit të Kosovës nga shërbyesit civil, asambleistët si dhe përfaqësues të OJQ-ve të cilët iu kanë drejtuar drejtorisë të DAP. Në këtë formë, i kemi kontribuar rritjes së performancës të punëtorët dhe njëkohësisht ofrimit të

shërbimeve të duhura. Për vitin 2019, janë shpenzuar 17806.00 L derivate si dhe janë kaluar gjithsej 187123 KM¹.

Krahasuar me vitin që lamë pas, kemi ulje të shpenzimeve në derivate. Me qëllim të uljes së shpenzimeve dhe tërheqjen nga qarkullimi i veturave të vjetra, vitin që lamë pas, jemi furnizuar me tri vetura të reja të cilat vihen në shërbim të zyrtarëve publik. Furnizimi (blerja) parashihet të zgjasë edhe në të ardhmen ku gradualisht do të largohen të gjitha veturat e vjetra të cilat shkaktojnë shpenzime të mëdha në derivate dhe mirëmbajtje vjetore. Veturat e larguara nga përdorimi në fund të vitit që lamë pas, me kërkesë të drejtorit të DAP janë proceduar në zyrën e prokurimit për t'u shitur.

Vlen të përmendet që të gjitha udhëtimet e lejuara janë pajisur vazhdimisht me fletëdaljet të nënshkruara nga drejtori i DAP si dhe Kryetari.

Angazhime tjera të drejtorisë:

Gjatë vitit 2019, DAP, nëpërmjet zyrtareve publik si dhe drejtorit të drejtorisë, është munduar që objektivat e parapara në fillim të vitit t'i përmbushë me efikasitet të lartë. Kjo drejtori, në bashkëpunim me sektor tjerë që funksionojnë në kuadër të organogramit komunal, ka arritur që të hartoj dhe dërgoj për implementim një sërë rregulloresh dhe propozim vendimesh. Ndër to janë:

- Rregullorja për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
- Rregullorja për Transparencë Komunale;

Gjithashtu janë hartuar dhe miratuar ose pritët të miratohen në fillim të vitit 2020 këto akte:

- Rregullorja për Plotësim Ndryshimin e Rregullores 01/2018 (01.Nr 02-104/01-11899) për Bashkëpunimin e Komunës me Vendbanimet, Fshatrat dhe Lagjet Urbane të Komunës Së Kaçanikut;

¹ Të dhënat janë gjeneruar nga raportet mujore nga autoparku dhe mund të dallojnë në vlera me raportet tjera financiare.

- Rregullorja për Taksa Komunale.

Në suaza të autorizimeve nga Kryetari i Komunës, përgjatë vitit 2019, DAP, e përfaqësuar nga drejtori ka marrë pjesë në dy komisione të Kuvendit të Komunës:

- Komisioni për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.

Gjatë pjesëmarrjes në këtë komision, është arritur që suksesshëm së bashku me 4 anëtarë tjerë të komisionit, të zgjedhen 30 kryetarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane. Me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ të ri që përcakton masa të reja lidhur me funksionimin e këtyre këshillave, komisioni ndërpret punën pa u përmbyllur procesi ku kishin mbetur vetëm 3 këshilla pa u zgjedhur.

- Komisioni për Emërimin, Riemërimin dhe Shqyrtimin e Ankesave të Rrugëve Lokale të Komunës së Kaçanikut.

Ky komision është themeluar në vitin 2018, mirëpo kurorëzimi i punës së tij është përmbyllur tek në fund të vitit 2019, ngase ky proces është vlerësuar shumë i ndjeshëm dhe me mjaft probleme të natyrave të ndryshme. Me aprovimin të propozim-vendimit në Kuvend, pjesëmarrja në këtë komision nga DAP është vlerësuar mjaft pozitive.

Është punuar në shumë dimensionë tjerë të cilat janë ndërlidhur ngushtë me imazhin e institucionit të komunës së Kaçanikut. Ka përpiluar raportin e integritetit, raportin e performancës si dhe tema tjera që ndërlidhen me DAP-in. Kryesisht kemi marrë pjesë edhe në shumë takime të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe nga ftesat e ndryshme prej DEMOS-it, USAID-it etj.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Shefi i Zyrës Komunale për kthim dhe komunitete gjatë vitit kalendarik 2019, ka realizuar planin vjetor në plotni.

Në zyrën komunale për komunitete dhe kthim nga shtetet tjera janë lajmëruar gjithsej tri familje me trembëdhjetë anëtar si dhe katër individ të ri-atdhesuar.

Të gjithë këto familja dhe individ janë futur në sistemin e të dhënave (SMR), janë intervistuar dhe vizituar në teren për gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale. Vizita është bërë në bashkëpunim me koordinatorin regjional të departamentit të ri integrimit si dhe nëpunësin e QPS-së.

Komisioni Komunal për ri integrim ka mbajtur tri takime për kërkesat e aplikuesve të ri integruar për të vendosur për kërkesat e tyre për mbështetje nga programi i ri integrimit.

Komisioni Komunal për Hartimit e planit tre vjeçar për ri-integrim të qëndrueshëm ka kryer punën e vet duke hartuar një plan të tillë, të cilin edhe e ka përcjell për kuvend ku edhe është miratuar ky plan.

Shefi i zyrës ka lëshuar 18 tetëmbëdhjetë vërtetime për persona të ri-atdhesuar.

Përveç punëve ditore të parapara me planin vjetor janë kryer edhe shumë detyra të cilat nuk janë të planifikuara, komisione të ndryshme, dalja në teren etj.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Inspektori Sanitar

Inspektori Sanitar bazuar në autorizimet Ligjore, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të popullatës, ka marrë të gjitha masat për pengimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse, kontrollimin e kushteve higjieno sanitare të objekteve ushqimore, shëndetësore, hoteliere, objekteve parashkollore, shkollore, objekteve të mbajtjes së higjienës personale, ujit, objekteve dhe aparateve për furnizim me ujë të pijshëm si dhe masat mbrojtëse të shëndetit të popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, dhe pirjes së duhanit në vendet publike. Gjatë periudhës një vjeçare të gjitha kërkesat e parashtruara pran zyrës së inspektorit sanitar janë kryer sipas detyrës zyrtare:

Pranime teknike mbi plotësimin e kushteve higjieno -sanitare të objekteve ,me kërkesë të palës për zhvillimin e veprimtarisë tregtare:

- Nr. i kërkesave 16 si dhe janë lëshuar 16 pëlqime tekniko- sanitare në shumë prej 640 €.

Në procedure e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve ndërtimore janë lëshuar pëlqime mbi harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro - teknike të ndërtimit :

- Nr. i kërkesave 3 si dhe janë lëshuar 3 pëlqime për lokacion dhe ndërtim në shumë prej 67.50 €.

Në procedurën e licencimit dhe ri-licencimit të ordinancave private shëndetësore në Ministrisë së Shëndetësisë :

- Nr. i kërkesave 11 si dhe janë lëshuar 11 aktvendime (pëlqime) në shumë prej 220 €.

Për mos respektim të ligjeve në fuqi -shkeljen e normave sanitare , janë shqiptuar gjoba mandatore:

- 7 gjoba në shumë prej 700 €;
- 3 gjoba në shumë prej 750 €;
- 1 gjobë 50 €;
- 2 gjoba nga 250 € me përmbaues privat.

Për mos respektim të Ligjeve në fuqi, pranë Gjykatës themelore –divizioni për kundërvajtje:

- Nr. i kërkesave 11;
- të ekzekutuara nga Gjykata deri më tani 4 lëndë, shuma 3.750€;
- Nr. i refuzuar i kërkesave nga Gjykata 3 (nuk ka qenë në juridiksionin e tyre).

Artikujve ushqimor që u ka skaduar afati i përqendrueshmërisë dhe janë konstatuar se këta artikuj ushqimor nuk janë për konsum ,me vendim janë asgjësuar 400 € në vlerë të artikujve;

- Inspektive të përbashkëta me inspektorët e nivelit qendror (AUV) - gjatë kontrollit zyrtar janë përpiluar 3 procesverbale;
- Janë lëshuar 20 vendime për kryerjen e kontrollit shëndetësor të punëtorëve që vijnë në kontakt të drejtpërdrejt me ushqimin ,me furnizim të popullatës me ujë të pijshëm ,me barnat farmaceutike ,mjekimin e pacientëve ;
- 3 vendime për kryerjen e D.D.D.(dezinfektim , dezinfektim dhe deratizim)ku gjatë inspektimit është vërejtur prezenca e insekteve në furrat e bukës dhe restorantet;

Gjatë inspektiveve në subjektet afariste janë përpiluar 180 procesverbale.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe inspektori sanitar ka qenë i angazhuar në komisionin komunal për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

Është raportuar rregullisht pran Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe njëherit kemi pas një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet përkatëse në veçanti me Policinë e Kosovës.

Mbështetur në të dhënat e monitorimit të jashtëm i cilësisë së ujit të ujësjellësit të Kaçanikut, për analizë të përbërësve kimiko-fizik dhe bakteriologjik të ujit të pijes për vitin kalendarik 2019 rezultoi si në vijim:

Sektori i Ujësjellësve dhe Kualitetit të Ujit

Rezultatet e analizave të ujit në aspektin fizik, kimik dhe bakteriologjik nga IKSHPK-ja:

dhe kuadri profesional i KRU Bifurkacioni nga Ujësjellësit Lokal-për vitin 2019:

1. Vendi i marrjes së mostrës: BiO3/Kaçanik - Rr. Ismail Raka

Nr.	Pika e mostrimit	Nr. i most.kim.	Poz. Kim.	% Paramet.	Nr. i most.bak.	Poz. Bakt.	% Paramet.	Cl.
1	Ujësjiellës Lokal R1	12	12		12	2		0.02-007
	Totali	12	12		12	2		

2. Vendi i marrjes së mostrës: BiO3/Kaçanik Bob - Te magjistrallja

Nr.	Pika e mostrimit	Nr. i most.kim.	Poz. Kim.	% Paramet.	Nr. i most.bak.	Poz. Bakt.	% Paramet.	Cl.
1	Ujësjiellës Lokal R1/R2	12	12		12	2		0.01-006
	Totali	12	12		12	2		

3. Vendi i marrjes së mostrës: BiO3/Kaçanik - Komuna

Nr.	Pika e mostrimit	Nr. i most.kim.	Poz. Kim.	% Paramet.	Nr. i most.bak.	Poz. Bakt.	% Paramet.	Cl.
1	Ujësjiellës Lokal R1/R2	12	12		12	1		0.01-0.05
	Totali	12	12		12	1		

4. Vendi i marrjes së mostrës: BiO3/Kaçanik - Rr. E. Duraku

Nr.	Pika e mostrimit	Nr. i most.kim.	Poz. Kim.	% Paramet.	Nr. i most.bak.	Poz. Bakt.	% Paramet.	Cl.
1	Ujësjiellës Lokal R1/R2	12	12		12	0		0.012-0.054
	Totali	12	12		12	0		

5. Vendi i marrjes së mostrës: BiO3/Kaçanik - Begracë, Sh.F.M.U "7 Shtatori"

Nr.	Pika e mostrimit	Nr. i most.kim.	Poz. Kim.	% Paramet.	Nr. i most.bak.	Poz. Bakt.	% Paramet.	Cl.
1	Ujësjiellës Lokal R1	12	12		12	0		0.03-0.06
	Totali	12	12		12	0		

6. Vendi i marrjes së mostrës: BiO3/Kaçanik - K.Vjetër Sh.F. "Qamil Ilazi"

Nr.	Pika e mostrimit	Nr. i most.kim.	Poz. Kim.	% Paramet.	Nr. i most.bak.	Poz. Bakt.	% Paramet.	Cl.
1	Ujësjiellës Lokal R1	12	12		12	0		0.01-0.062

Totali	12	12	12	0
--------	----	----	----	---

Tabela 3. Rezultatet e analizave të ujit.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Puna gjatë vitit 2019 vlerësohet të jetë e mirë, punëtorët kanë respektuar orarin dhe disiplinën në punë, të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve janë kryer në të gjitha njësitet organizative të QKMF-së, andaj në formë kronologjike në vazhdim pasqyrohet puna një-vjeçare e kësaj qendre.

Gjatë vitit 2019, janë mbajtur takimet e rregullta mujore të Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues, me ç'rast janë diskutuar çështje të ndryshme profesionale si dhe çështje të tjera organizative që ka të bëjë me funksionimin më të mirë të punës në QKMF.

Vizitat shtëpiake për të sëmurët në stadin terminal të kancerit si dhe të sëmurët e palëvizshëm si dhe vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç, janë realizuar gjatë vitit 2019 nga ana e ekipeve tona mjekësore. Klasa për nëna dhe fëmijë, që funksionon në QKMF-Kaçanik nga viti 2017, ka kryer aktivitetet e saja duke organizuar dy here në javë (të martën dhe të premten) ligjërata për gratë shtatzëna, si dhe ato femra që planifikojnë të bëhen nëna, me ç'rast klientëve ju ofrohen edhe këshilla mjekësore si dhe barna që janë të domosdoshme për shtatzëni.

Janë bërë inspektime në terren, si dhe në ndërrimin e natës, me ç'rast është vërejtur se punëtorët respektojnë orarin dhe disiplinën në punë dhe terreni gjatë vitit 2019, ka qenë i mbuluar me mjekë dhe infermierë sipas orarit të përcaktuar nga Drejtoria e QKMF-së.

Mirëmbajtja e pajisjeve elektroenergjetike gjatë vitit 2019 ka qenë në rregull nga ana e kompanisë, e cila është kontraktuar nga ana e komunës.

Raportet ditore për sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare, raportet javore për sëmundjet infektive, si dhe raportet për sëmundjet kronike masovike jo ngjitëse sëmundjet malinje janë dërguar me rregull në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Mirëmbajtja e veturave gjatë vitit 2019 vlerësohet të ketë qenë në nivel.

Njësia e vaksinimit ka qenë e angazhuar në QKMF dhe në terren sipas orarit të paraparë nga Drejtoria e QKMF-së.

Shërbimet teknike kanë kryer punën e tyre, vëmendje i është kushtuar pastërtisë brenda objektit të QKMF-së, si dhe hapësirave jashtë saj.

Ka vazhduar aktiviteti në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, me ç'rast janë mbajtur edhe ligjërata për mjekë dhe infermierë të parapara edhe miratuar nga Oda e Mjekëve dhe Oda e Infermierëve.

Barnatoret nuk kanë kujdestaruar pas orës 24 dhe kjo situatë ka paraqitur problem për stafin, si dhe për pacientet e që ne shpresojmë që kjo çështje do të zgjidhet në vitin 2020.

Është punuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore primare dhe implementimi i konceptit të mjekësisë familjare në QKMF, QMF dhe AMF.

Më datën 16 dhe 17 janar 2019, është mbajtur punëtorja për programin për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç, me ç'rast është vlerësuar lartë performanca e QKMF-së, në implementimin e këtij programi.

Më datën 20 mars 2019, kemi marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga „AQH” zvicerane, punëtori që është mbajtur në Ferizaj, e që ka të bëjë me planin e veprimit për kujdesin primar shëndetësor dhe Komuna e Kaçanikut ka paraqitur planin e veprimit.

Më datën 22 mars 2019, kemi pranuar donacion për QKMF-në nga kompania farmaceutike „CFO” nga Prishtina një kontingjent prej 870 ampulave „Drotaverin”, në vlerë prej 548.10 €. Ky donacion është sjellë nga përfaqësuesi i kësaj kompanie Dr. Qëndrim Kqiku, si dhe mjeku që punon në QKMF-Kaçanik, Dr. Bajrush Miftari.

Gjatë muajit mars 2019 është bërë hapja e konkursit për pranimin e një mjeku, me dhe janë kryer të gjitha procedurat e intervistimit (me gojë dhe me shkrim) si dhe është pranuar një mjekë.

Më datën 16 prill 2019, kemi pranuar donacion nga bashkatdhetari ynë z. Remzi Gashi një kontingjent të kollestomave, si dhe material shpenzues mjekësor.

Më datën 17 prill 2019, kemi marrë pjesë në punëtorinë e radhës të organizuar nga „AQH” zvicerane, që ka të bëjë me planin e veprimit për kujdes primar shëndetësor.

Më datën 19 prill 2019, kemi proceduar në komunë konkursin për pranimin e gjashtë infermierëve të përgjithshëm. Pas përgjigjes pozitive nga DSHMS-ja, konkursi është hapur me datën 30 prill 2019 dhe është shpallur në gazetën “Epoka e Re”.

Më datën 24 prill 2019, kemi pranuar donacion nga bashkë atdhetarja jonë Nita Mjaku-Provoliu, një kontigjent të kollestomave, gella si dhe material tjetër shpenzues mjekësor.

Më datën 07 maj 2019, kemi pranuar 36 kompjuterë nga Ministria e Shëndetësisë për nevojat e QKMF-së, si dhe 2 switcha janë pranuar me datën 13 maj 2019. Këto pajisje do të shërbejnë për instalimin e sistemit të ri informative shëndetësor në QKMF dhe terren dhe me këtë do të bëhet digjitalizimi i të gjitha shërbimeve shëndetësore në QKMF.

Më datën 12 maj 2019, është shënuar dita ndërkombëtare e Infermierisë, me këtë rast një ekip mjekësor ka qëndruar në sheshin „Ismajl Raka” dhe i kanë ofruar shërbime shëndetësore falas qytetarëve tanë.

Më datën 23 maj 2019, kemi pranuar donacion nga „AMC” -Aksioni për nëna dhe fëmijë suplemente për shtatzëna “prenatal vitamina” 15 paketa dhe ky donacion do të ju ndihmoj grave shtatzëna që ti sigurojnë falas këto suplemente, pa pasur nevojë t’i blejnë ato.

Më datën 23 maj 2019, janë kryer të gjitha procedurat intervistuese për kandidatët që kanë aplikuar në pozitën infermier i përgjithshëm dhe komisioni përzgjedhës i ka përzgjedhur 6 kandidatë të cilët i kanë përmbushur kushtet për pranim. Kandidatët e pranuar kanë filluar punën me datën 01.06.2019.

Më datë 28 maj 2019, kemi marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga „AQH” zvicerane e cila është mbajtur në Prishtinë. Tema e kësaj punëtorie ka qenë evaluimi dhe monitorimi i planit të veprimit për kujdesin primar shëndetësor. Vlen të theksohet se komuna jonë ka aplikuar tek „AQH” me plan të veprimit.

Më datën 31 maj 2019, është shënuar dita ndërkombëtare kundër duhanit, me këtë rast një ekip mjekësor ka dalë në sheshin „Ismajl Raka” dhe i kanë informuar për rreziqet e konsumimit të duhanit si dhe pasojat e tij, po ashtu janë shpërndarë edhe fletushka.

Më datën 17 qershor, kemi bërë organizimin e orarit të punës ku në ndërrimin e pasdites kanë punuar 3 mjekë që kanë filluar nga ora 15.00-22.00, kurse nga ora 18.00 deri 24.00, ekipi mjekësor është asistuar edhe me një infermiere.

Në muajin korrik është mbajtur trajnimi i mjekëve dhe infermierëve për sistemin e ri informativ shëndetësor, kurse nga data 22 korrik 2019, ka filluar së implementuari, ku është bërë digjitalizimi i të gjitha shërbimeve shëndetësore që kryhen në QKMF-Kaçanik.

Më datë 28.07.2019, një ekip mjekësor ka qenë prezent në aktivitetet që janë organizuar për bashkatdhetarët tanë. Ky aktivitet është mbajtur në fshatin Shtrazë.

Gjatë muajit gusht është bërë rrënimi i objektit të vjetër të QMF në Kaçanik të Vjetër, kurse para rrënimit komisioni i cili është caktuar nga Drejtoria e QKMF-së, ka bërë bartjen e inventarit të përdorshëm nga QMF-ja e vjetër në QMF-në e re.

Në fund të muajit gusht është thyer dhe demoluar objekti i AMF-së në fshatin Elezaj. Lidhur me këtë rast është njoftuar policia.

Më datë 29.08.2019, drejtori i QKMF-së ka marrë pjesë në punëtorinë për programin për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç, me ç'rast është vlerësuar lartë performanca në realizimin e këtij program.

Me datën 03 shtator 2019, kemi pasur inspektim nga Ministria e Shëndetësisë (4 inspektorë), të cilët kanë bërë inspektimin e QKMF-së dhe ata janë ndarë të kënaqur me kushtet që i ofron institucioni ynë.

Më datë 20 shtator 2019, kemi pasur në vizitë një delegacion nga Programi Kombëtar i Kontrollit të Tuberkulozit të prirë nga Dr. Majlinda Bala Gjocaj, Prof. Dr. Gjyle Mulliqi dhe Prof. Dr. Gazmend Zhuri. Ata vlerësuan lartë performancën e QKMF-së, si dhe kushtet që ofron institucioni ynë për pacientët tanë.

Më datën 27 shtator 2019, në hapësirën e QKMF-së është mbajtur takimi i koordinatorëve dhe infermiereve të 5 komunave (Gjilan, Kamenicë, Viti, Kaçanik dhe Hani i Elezit), të cilët zbatojnë programin për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç. Në këtë takim, kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, UNICEF-i dhe AMC-ja.

Prej datës 06 deri 13.10.2019 është mbajtur trajnimi për emergjencë mjekësore në Izmir të Turqisë, ku nga QKMF-ja ka marrë pjesë Dr. Skender Gashi. Ky trajnim është organizuar nga Ministria e Shëndetësisë në kuadër të bashkëpunimit Kosovë-Turqi.

Më datën 14.10.2019, i kemi pasur në vizitë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë të cilët kishin ardhur në QKMF-Kaçanik në cilësinë e monitoruesve dhe interesimi i tyre ishte lidhur me Sistemin Informativ Shëndetësor.

Më datë 24.10.2019, kemi filluar vizitat sistematike mjekësore në të gjitha shkollat fillore të Komunës së Kaçanikut.

Më datë 31.10.2019, kemi pranuar donacion nga kompania farmaceutike „Santefarm” një kontigjent prej 240 pakove të antibiotikut “Duoclav 625 mg. (Amoxicillin 500 mg+125 mg Acid klavulanik)” për nevojat e pacientëve të QKMF-së.

Në muajin nëntor ,kanë përfunduar vizitat sistematike mjekësore në të gjitha shkollat fillore të komunës .

Më datë 07.12.2019, është bërë furnizimi me vaksina të gripit sezonal dhe nga data 09 dhjetor 2019, ka filluar vaksinimi i kategorive sipas indikacioneve mjekësore.

Më datë 17.12.2019, kemi marrë pjesë në takimin e fund vitit për programin nacional për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, UNICEF-i dhe AMC-ja, me ç’rast Komuna e Kaçanikut është shpallur e para në nivel republike në realizimin me sukses të këtij programi.

Më datë 23.12.2019, kemi marrë pjesë në takimin përmbyllës për vitin 2019, me ç’rast janë prezantuar të arriturat për vitin 2019 për kujdesin primar shëndetësor në Kosovë, si dhe plani për koordinimin e aktiviteteve për vitin 2020.

Më datë 28.12.2019, ka arritur aparati i ri i rëntgenit në QKMF, kurse instalimi i tij ka përfunduar me datën 29.12.2019.

Qendra për Punë Sociale

Gjatë vitit 2019 Shërbimi profesional i Qendrës për Punë Sociale në Kaçanik, është angazhuar në realizimin e programit të punës duke punuar në të gjitha format që kanë të bëjnë me Mbrojtjen Sociale. Gjatë kësaj kohe, kemi zbatuar tërë legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Shërbimin Social.

Fëmijët pa kujdes prindëror:

- Fëmijët pa dy prindër;
- Fëmijët e braktisur;
- Prindërit e fëmijëve që nuk i kryejnë detyrat prindërore.

FËMIJËT PAKUJDEZ PRINDOR	NR. I FËMIJËVE/ MUJORI 2019	PËRZGJEDHJA E FAMILJES	KUJDESTARI	STREHIMI I PËRKOSHËM	STREHIMI FAMILJAR	ADOPTIMI	REFERENCA NË INSTITUCIONET TJERA	PREGADITJA E STREHIMIT	PËRCJELLJA E FËMIJËVE NËN PËRKUJDESJE	RASTET NË PROCES	TË MBYLLURA	TOTAL
FËMIJËT PA DY PRIND	11	-	11	-	-	-	po	-	Të gith fëmijët janë përcjellur	2		13
FËMIJËT E BRAKTISUR	1	jo	po	-	jo	jo	Në gjyaktë	-		1		1
PRINDËRIT E FËMIJËVE QË NUK I KRYEJN OBLIGIMET	12	PO				-	PO	-	PO	5	2	19

Tab. Nr. 4.

Nga tabela e lartshënuar konstatojmë këtë:

Fëmijë të braktisur: gjatë vitit 2017 kemi pasur një fëmijë të braktisur i cili edhe sot është në proces të Gjykatës Supreme.

Prindërit e fëmijëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindërore:

Fëmijët e familjeve në konflikt me ligjin:

- Keqtrajtimi i fëmijëve dhe lënia pas dore;
- Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të çrregulluara;
- Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar.

FËMIJËT E FAMILJEVE NË KONFLIKT	NDËR MJET ËSIMI	STREHIMI I PËRKOHËSHË M I FËMIJËVE	INICIMI I PROCEDURA VE PËR MARRJEN E TË DREJTËS PRINDORE	CAKTIMI I KUJDEST ARIT	BASHKË PUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA	RASTE NË PROCE S	TË MBYLLURA
A) KEQËTRAJTIMI DHE LËNJA PAS DORE	7	-	1	-	po	5	2
B) FËMIJËT E FAMILJEVE ME MARËDHËNJË TË ÇRREGULLUARA	10	-	-	-	PO	5	5

Tab. Nr. 5.

Gjatë këtij viti të 2019 jemi ballafaquar edhe me prindërit të cilët nuk kanë pasur kujdes ndaj fëmijëve të tyre.

Zyrtarët e Shërbimit Social janë marrë me përkujdesjen dhe përcjelljen e rastit, fëmijët janë vizituar dhe është biseduar me prindërit e tyre. Më lartë (tab.5) kemi paraqitur tabelë e kësaj forme të Mbrojtjes Sociale.

Në këtë periudhë kohore jemi ballafaquar edhe me problemin e fëmijëve të familjeve me çrregullime bashkëshortore ku ky numër i fëmijëve arrin në 10. Ndërsa, në trajtim të QPS, nga Zyrtarët e Shërbimit Social këtyre fëmijëve iu është dhënë mendimi për besueshmërinë e njërës prindëri cili ka aftësi për tu kujdesur për rritjen dhe zhvillimin normal të cilat janë kërkuar nga gjykata.

Fëmijet dhe rinia me sjellje të çrregulluar	Puna me familje dhe fëmijë	Bashkpunimi me shkollë	Me policij	Me gjyq	Me OJQ	Propozimi i masës educative dhe alternative	Përcjellja e masës educative dhe alternative	Rastet në proces të rij/të vetër	Të mbyllur	Total
a) Fëmijët me sjellje asoiale të mosh. 14	4	4	po	po	po	3	po	3	-	8
b) Rinia me sjellje asoiale 14-18	10	5	-	po	po	-	-	-	-	15
Delikuentët e ri prej 14-16 v.	Për vitin 2019 35	po	po	po		po	po		po	35
Delekkuentët e rritur 16-18	40	po	po	30		po	po		po	40

Tab. Nr. 6. Fëmijët dhe rinia me sjellje të çrregulluara.

Prej këtij numri të 75 delikuentëve, 25 kanë kryer vepra penale, 50 kanë kryer vepra kundërvajtëse. Struktura gjinore e tyre është 70 meshkuj dhe 5 femra. Nga ky numër i delikuentëve kemi 15 përsëritës të veprave (Recidivistë). Masa të shqiptuara ndaj këtyre delikuentëve kemi : 25 delikuent kanë masën edukative- Kujdesi i shtuar prindëror, 4 delikuent kanë masën - Kujdesin e shtuar të Organit të Kujdestarisë dhe 5 delikuent me masën punë me interes publik. Të tjerat janë në procese të gjykatave. Në rastet e delikuentëve zyrtarët e Shërbimit Social kanë marr pjesë gjatë intervistimit nga ana Policisë së Kosovës në Kaçanik në 75 raste në kohë të ndryshme.

Strehimi në strehimore:

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 4 raste të strehuara në strehimore në Ferizaj. Gjinia e tyre ka qenë femra të cilat kanë pasur dhunë në familje por edhe nga personat jashtë familjes. Qëndrimi tyre ka qenë prej një dite deri në tri ditë.

DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor

Në të gjitha shkollat amë fillore e të mesme të ulëta funksionojnë paralelet parafillore me përjashtim të SHFMU "Naim Frashëri" në Kotlinë ku një vit më parë pati filluar edhe në këtë shkollë paralelja parafillore, ndërsa në ndërkohë kjo paralele e ka ndërprerë funksionimin e saj në mungesë të fëmijëve parafillor. Këtë vit shkollor 2019-2020 janë regjistruar gjithsej 472 fëmijë të shpërndarë në 40 grupe. Përmes organizimit të këtij niveli shkollor synojmë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo fëmije, ndërkaq që në klasën e parë, në fillim të vitit shkollor 2019/2020 janë regjistruar gjithsej 481 fatos.

Ngritja e cilësisë, zbatimi i plan-programit mësimor, përgatitja e dosjeve (portofolio) me shkrim e mësimdhënësve për orë mësimore

Implementimi i reformave në mësimdhënie dhe nxënie, me theks të veçantë zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversitar) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë.

Për vitin 2019 faktori kryesor për mosrealizimin e planit dhe programit mësimor ka qenë greva e mësimdhënësve e organizuar nga SBASHK-u. Humbja e orëve mësimore dhe mos zëvendësimi i tyre ka ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë në arsim. DKA ka qenë e pafuqishme për të ndikuar në zëvendësimin e orëve të humbura gjegjësisht në realizimin e planit mësimor.

Ngritja e cilësisë mbetet prioritet bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve por edhe ngritjen e përpjekjeve dhe përgjegjësisë në punë. Gjatë muajve qershor-korrik dhe shtator janë trajnuar gjithsej 67 mësimdhënës në 6 fushat kurrikulare. Ndërkaq, gjatë muajve nëntor-dhjetor është bërë kontrollimi i dosjeve (portofolio) të mësimdhënësve për fushat: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë, Shkenca të natyrës, Shoqëria dhe Mjedisi, Sporti dhe shëndeti dhe Mësimi klasor, aktivitet që po ashtu ka qenë në funksion të ngritjes së cilësisë dhe zbatimit të Kurrikulës së re.

Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë

Ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, respektivisht sipas kurrikulës së re i bazuar në rezultatet e të nxënësve për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore.

Në afatin e qershorit, në fund të vitit mësimor 2018-2019, testit të maturës i janë nënshtruar gjithsej 453 maturantë të dy shkollave të mesme të larta. Në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 287 nxënës maturant të cilët i janë nënshtruar provimit, rezultat pozitiv kanë treguar 237 prej tyre apo 82.57 %. Ndërkaq, në SHMP nga gjithsej 166 nxënës maturant të cilët i janë nënshtruar provimit, atë e kanë kaluar vetëm 25 prej tyre ose 15.06%. Ndërkohë, që në afatin e dytë (të gushtit) në provimin e maturës, nga të dy shkollat kanë hyrë 132 maturant, duke përfshirë edhe ata nga vitet e më hershme, ndërsa kanë kaluar 67 prej tyre apo 50,75 %.

Gjatë vitit shkollor 2018-2019, në dy shkollat e mesme, mësimet i kanë vijuar 525 nxënës maturant, prej tyre 287 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 238 në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka".

Ndërkaq, Testit të Arritshmërisë në fund të vitit mësimor 2018-2019 i janë nënshtruar 494 semimaturant nga 12 shkolla amë fillore e të mesme të ulëta dhe 7 paralele të ndara fizike, të cilat e kanë përfunduar klasën e nëntë.

Semimaturantët kanë arritur rezultate relativisht të mira duke arritur nivelin e kalueshmërisë në shkallë komune prej 49.89 %. Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Agim Bajrami" nga Stagova ka arritur rezultatin më të mirë duke u radhitur e para me shkallë të kalueshmërisë prej 59,11 %, shkolla e dytë është radhitur SHFMU "EminDuraku" nga Kaçaniku me 56,37 % e treta SHFMU "Qamil Ilazi" nga Kaçaniku i Vjetër me 53,58 %, e katërta SHFMU "Jusuf Gërvalla" me 51,43 % etj.

Funksionimi i organeve të shkollës: Këshilli Drejtues i Shkollës, Aktivitet Profesional, Koordinatorët e cilësisë dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos regjistrimit

Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, ndarja e punëve dhe përgjegjësisë në përpunime me rolin e tyre dhe aktivizimi i organeve ekzekutive dhe profesionale në shkollë, ndikon drejtpërdrejtë në arritjen e rezultateve të mira të shkollës.

Këshillat Drejtuese të Shkollave në disa shkolla nuk funksionojnë fare apo funksionojnë dobët prandaj DKA do të vazhdojë me këmbëngulje të kërkojë nga drejtorët e shkollave funksionalizimin e tyre. Aktivitetet profesionale janë aktive në të gjitha shkollat. Koordinatorët e përzgjedhur janë angazhuar në sigurimin e cilësisë përmes procesit të planifikimit gjithëpërfshirës ku janë pasqyruar nevojat dhe prioritetet e shkollave dhe në përgjithësi zhvillimin e arsimit, ndërsa Ekipet për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe mos regjistrimit si mekanizëm parandalues është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë.

Zhvillimi i aktiviteteve shkollore e jashtë mësimore

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, me qëllim të nxitjes së nxënësve për thellimin e njohurive të tyre, në vazhdimësi ka organizuar dhe mbajtur gara shkollore të diturisë në nivel komunal e nivele tjera duke përfshirë edhe ato republikane.

Gjatë vitit shkollor 2018-2019 garat komunale të diturisë nuk janë mbajtur si zakonisht për nderë të Ditës së Çlirimit dhe sipas formatit të viteve të mëhershme, por është zbatuar Programi Nacional për Rini Kulturë dhe Sport, një program i mbështetur në parimet themelore të gjithë përfshirjes së nxënësve. Programi Nacional për Rininë është implementuar nga Zyra e Koordinatorit Nacional për Rini në koordinim me DKA-në, edhe në shkollat e Komunës sonë në tri nivele; Niveli Shkollor, Komunal dhe Republikan, ndërsa garat janë planifikuar të mbahen në 3 fusha, ndërkohë që vitin që e lamë pas janë mbajtur në 2 prej tyre: Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik dhe Garat e Diturisë.

Garat në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik kanë qenë një mundësi e mirë që nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese dhe fuqinë e mendimit nëpërmjet krijimeve kreative, ndërsa garat janë mbajtur në kategoritë: Art muzikor, (Edukatë muzikore), Art pamor (Edukatë figurative) dhe Recitim/aktrim. Garat e Diturisë kanë përfshirë testet në lëndët mësimore: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Gjuhë Angleze, Biologji, Kimi, Fizikë, Edukatë Qytetare, Histori dhe Teknologji e Informimit dhe Komunikimit, ndërkaq garat janë zhvilluar në nivelin fillor, nivelin e mesëm të ulët dhe mesëm të lartë ku janë përfshirë të gjithë nxënësit.

Në garat e Kreativitetit Kulturor dhe Mendim Kritik, në nivel shkollor në Komunën e tonë janë shpërblyer dhe pajisur me Certifikata nga Qeveria e Republikës së Kosovës, rrjedhimisht nga Koordinatori Nacional gjithsej 444 nxënës në kategoritë përkatëse ndërkaq në nivel Komunal janë shpërblyer e po ashtu janë pajisur me Certifikata dhe me një set librash në vlerë 50 euro gjithsej 164 nxënës nga klasa 1- 12.

Ndërkohë në nivel Republikan janë shpërblyer 5 nxënës me bursë në vlerë 300 euro (një nxënës) dhe 400 euro (4 nxënës). Në garat e Diturisë, në nivel shkollor, 561 nxënës nga klasa 1 – 12 kanë zënë vendet e para në lëndët përkatëse dhe janë pajisur me Certifikata nga Qeveria e Republikës së Kosovës, rrjedhimisht nga Koordinatori Nacional, ndërkaq në nivel komunal 72 nxënës nga klasat 3 – 12, kanë zënë vendet e para në lëndët përkatëse të cilët janë kualifikuar të garojnë në nivel republikan.

Në nivel Republikan në Garat e Diturisë, 13 nxënës të Komunës sonë, nga klasa 3 – 12, janë shpërblyer pasi kanë zënë vendet e para, të dyta dhe të treta, ndërkaq tani më nxënësit e shpërblyer janë duke realizuar një kamp kreativ njëjavor me fituesit e tjerë në nivel vendi. Vlen të theksohet se nxënësit e Komunës sonë kanë zënë më shumë vende të para, të dyta e të treta se nxënësit e secilës komunë tjetër në vend, që gjithsesi duhet vlerësuar.

Edhe gjatë vitit shkollor 2018-2019, përveç garave të diturisë, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe garave tjera e aktiviteteve të ndryshme. Një aktivitet që duhet veçuar është edhe pjesëmarrja e nxënësve në garat e recitatorëve në Manifestimin “Flakadani i Karadakut 2019” në Viti. Në këtë garë, sikurse edhe viteve të mëhershme, kanë marr pjesë 5 nxënës nga SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” të cilët edhe janë shpërblyer nga organizatori.

Në nivel shkollor, komunal e republikan janë organizuar edhe garat e ndryshme sportive si në futboll, basketboll, hendboll etj.

Gara janë organizuar edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Federatën e Sportit Shkollor dhe Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike, e po ashtu edhe përmes projektit BRICK (Building Resilience in Individuals Communities in Kosovo – Ndërtimi i Qëndrueshmërisë të Individit dhe Komunitetet në Kosovë) janë organizuar gara sportive në futboll të vogël me nxënësit e shkollave fillore e të mesme të ulëta, me ekipet e meshkujve dhe femrave, ndërsa shkollat janë mbështetur edhe me pajisje sportive.

Investimet në objektet shkollore

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar ndërtimi i 3 objekte të reja shkollore: në Kaçanik të Vjetër që ende nuk ka përfunduar, në Gllloboçicë i cili ka përfunduar dhe ka filluar përdorimi, në Kovaçec kanë përfunduar punimet por në mungesë të inventarit ende nuk shfrytëzohet nga nxënësit, në Kaçanik objekti i çerdhes së re për fëmijë ka përfunduar dhe ka filluar përdorimi ndërkohë që filluan punimet dhe përfunduan brenda një viti për ndërtimin e objektit të ri në Ivajë. Ndërkohë që gjatë vitit 2019, ka filluar ndërtimi i aneksit të Shkollës së Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” dhe fillimi i punimeve për ndërtimin e objektit të ri shkollor në Doganaj.

Nga Buxheti Komunal në rregullimin e infrastrukturës shkollore janë investuar 68,882 euro. Renovime janë bërë në: SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, në objektin e lagjes Dushkaja ku është bërë sanimi i defekteve të ujit, sanimi i nyjave sanitare dhe janë meremetuar muret e dëmtuara të cilat janë riparuar dhe ngjyrosur, ndërkaq është investuar edhe në objektin e shkollës së Runjevës, paralele e ndarë e SHFMU “Emin Duraku” ku është instaluar ngrohja qendrore. Në objektin e SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë është meremetuar kulmi i shkollës pastaj sanimi dhe izolimi i pllakave të dëmtuara dhe rregullimi dhe ngjyrosja e plafonit me ngjyrë dekorative.

Në infrastrukturën shkollore është investuar edhe në shkollën e Bajnicës, paralele e ndarë e SHFMU “Nazmi Osmani” dhe në shkollën e Begracës. Në shkollën e Bajnicës është ndërtuar rrethoja përgjatë objektit dhe në fushën sportive janë ndërtuar shkallët nga betoni për shikues, ndërkaq janë shpenzuar afër 12 mijë euro, ndërsa në SHFMU “7 Shtatori” në Begracë është sanuar sistemi i rrymës elektrike, ndërkaq janë investuar mbi 3 mijë euro.

Investime të tjera janë bërë edhe për pajisjen e çerdhes së fëmijëve me pajisje e mjete të nevojshme për funksionimin normal të saj. Në ndërkohë edhe në shkollën e Bajnicës, paralele e ndarë e SHFMU “Nazmi Osmani” është realizuar projekti i efikasitetit të energjisë ku është bërë instalimi i ngrohjes me avull, izolimi termik, ndërrimi i dritareve, renovimi i kulmit etj.

Ndërkaq, në 3 shkolla të tjera (SHFMU “Jusuf Gërvalla”, SHFMU “Idriz Seferi” dhe SHFMU “Qamil Ilazi”) janë instaluar kamerat e sigurisë, ndërsa në 2 shkollat: në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik dhe “7 Shtatori” në Begracë

është investuar në kabinetet e Kimisë ku janë pajisur me tërë inventarin e nevojshëm dhe mbetet furnizimi me pajisje laboratorike.

Gjatë vitit 2019, shuma e investuar në objektet shkollore nga ministritë dhe donatorët e jashtëm është:

1. SHFMU "Qamil Ilazi" Kaçaniku i Vjetër323,670.80 euro
2. SHFMU "Gafur Luma" Gllloboçicë227,653.75 euro
3. QEAP "Agimi" Kaçanik140,474.35 euro
4. SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" Kaçanik152,515.82 euro
5. Gjimnazi "Skenderbeu" Kaçanik42,110.64 euro
6. SHFMU "Nazmi Osmani" Bajnicë40,252.29 euro

Përmirësimi i aktiviteteve rinore

Gjatë vitit 2019 nga kategoria e subvencioneve janë mbështetur aktivitetet rinore duke i përfshirë një varg aktiviteteve sportive e aktivitete tjera nga fusha të ndryshme. Janë shënuar të gjitha datat e rëndësishme në nivel komunal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Njëkohësisht, është arritur të bëhet masivizimi dhe ngritja në nivel më të lartë e aktiviteteve rinore – sportive. Fuqizimi i KVRL përmes aktiviteteve si dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu janë organizuar edhe vizita studimore lidhur me trashëgiminë kulturore.

Organizimi i aktiviteteve kulturore

Ndër aktivitetet kulturore me peshë më të madhe është organizimi i Festivalit të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore "Kaçaniku 2019", pritja dhe organizimi i eventeve të ndryshme për mërgimtarët gjatë muajve të verës dhe organizimi i festivalit të këngës për fëmijë. Duke subvencionuar Shoqëritë Kulturo-artistike është ruajtur tradita e këngëve dhe valleve popullore që kultivohen në trojet shqiptare. Gjithashtu janë mbështetur edhe organizatat kulturore që veprojnë në Komunën tonë në mbarëvajtjen e aktiviteteve të tyre.

Organizimi i aktiviteteve sportive

Janë organizuar turnirë të ndryshëm me rastin e datave të rëndësishme vendore, kombëtare e ndërkombëtare me ç'rast krahas këtyre aktiviteteve është bërë edhe identifikimi dhe promovimi i talenteve të rinjë për aktivitetet sportive.


Gjithashtu janë mbështetur edhe klubet sportive që veprojnë në komunën tonë për mbajtjen e aktiviteteve (garave) të tyre vjetore.

Në përgjithësi për kulturë rini dhe sport duke përfshi edhe rininë shkollore gjatë vitit 2019 nga kategoria e subvencioneve për aktivitete të ndryshme dhe bursa të studentëve janë shpenzuar mbi 100,000 euro.

Shuma e investuar në objektet kulturore dhe sportive gjatë vitit 2019 është:

1. Palestra sportive445,190.13 euro;
2. Fusha e futbollit afër palestrës37,514.20 euro;
3. Fusha e futbollit te stadiumi7,000 euro.

Qendra rinore në Shtëpinë e Kulturës70.000 euro.



DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT

Mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 84. të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit (me shkurtesë DFEZH), në punën dhe aktivitetin e saj gjatë vitit 2019 në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi të sajë ka zhvilluar aktivitetet si vijon:

Përgatitja dhe hartimi i draft-rregulloreve komunale dhe akteve të tjera ligjore nga fushëveprimi i financave; menaxhimi, mbikëqyrja e të gjitha operimeve financiare së bashku me procedurat e ekzekutimit të buxhetit të komunës në pajtim me LMFPF, LFQL dhe dispozitat e tjera ligjore; asistenca për Kryetarin e Komunës dhe KPF-në në përgatitjen e Buxhetit vjetor të komunës, këshillimi dhe komentet mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me buxhet, si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë për të gjitha aktivitetet, lidhur me përcaktimin e objektivave zhvillimore dhe të sektorëve strategjike të zhvillimit të komunës.

Mbajtjen e të gjitha llogarive në komunë, në bashkëpunim me Thesarin dhe përgatitjen e raporteve financiare vjetore, për një proces transparent buxhetor, të gjitha këto, me një shkallë të lartë të mbikëqyrjes së të gjitha drejtorive. Menaxhimin me pagesat në Thesar, mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit, hartimi i planeve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës dhe angazhimi për krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për zhvillimin e ekonomisë së komunës, me theks të posaçëm, për zhvillimin e NVM-ve, zbatimi i rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat vjetore, të cilat kanë të bëjnë me drejtorinë, duke bërë inkasimin e drejtpërdrejt të hyrave vetjake komunale nga taksa obliguesit, përfshirë edhe tatim në pronë si dhe punë të tjera të caktuara nga kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

Sektori i Financave

Buxheti

Cash Plani

Bazuar në Rregulloren MF - Nr. 02/2017 për alokimin e fondeve, e cila përcakton procesin për alokimin e fondeve sipas LMFPF-së dhe Ligjit vjetor për

Buxhetin e Republikës së Kosovës, në fillim të vitit 2019 është përgatitur Kesh Plani akumulativ për të gjitha programet, nën-programet e Organizatës Buxhetore – Komuna Kaçanik, është finalizuar sipas ndarjeve buxhetore të Ligjit të Buxhetit dhe planifikimit për zotimin përkatësisht shpenzimin e tyre. Kesh Plan final i përgatitur është dorëzuar në FTP Serverin e Thesarit sipas udhëzimeve të Thesarit.

Raportet e Shpenzimeve

Në afate të rregullta tre mujore janë hartuar raporte mbi shpenzimin e buxhetit komunal, të cilat janë dërguar në Kuvendin Komunal për diskutim dhe shqyrtim të mëtejshëm. Për të arritur një transparencë buxhetore, gjitha raportet e hartuara kanë përmbajtur shënime të hollësishme apo analitika për shpenzimet e ndodhura.

Llojet e raporteve të hartuara dhe shpalosura për publikun e gjerë janë: TM1/2019 ; TM2/2019; TM3/2019 dhe Raporti Vjetor Financiar 2019.

Shpenzimet - Certifikimi dhe Aprovimi i Pagesave

Shpenzimi i parasë publike kërkon një kontroll të mirë të ndjekjes së procedurave dhe ekziston rregullore e veçantë **“RREGULLORE FINANCIARE NR.01/2013/MF - SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE”** përmes së cilës përveç tjerash sigurohet kontrolli i brendshëm si proces integral që ndikohet nga udhëheqësit dhe personeli i njësisë dhe ka për qëllim për të dhënë bindje të mjaftueshme që duke synuar kah realizimi i misionit të njësisë, janë duke u arritur këto objektiva të përgjithshme:

- a. Ekzekutimi i rregullt, etik, efikas dhe efektiv i operimeve;
- b. Plotësimi i obligimeve të llogaridhënies;
- c. Veprimi në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme;
- d. Mbrojtja e burimeve nga humbja;

Bazuar në këtë rregullore dhe procedurat tjera ligjore, gjatë vitit 2019 janë përfunduar të gjitha punët rreth shpenzimit të buxhetit komunal si në vijim:

- Regjistrimin e gjitha pagesave të shpenzuara sipas programeve buxhetore,

- Raportimi çdo mujor për faturat e pa paguara për vitin 2019,
- Përgatitje të shkresave të ndryshme për dezotimin e mjeteve, anulimin e shpenzimeve, anulimin e urdhërblereve,
- Përgatitja dhe paraqitja e kërkesave të vazhdueshme në MF rreth harmonizimeve dhe rialokimeve të mjeteve buxhetore, etj.

Gjithsej pagesat nga të gjitha kategoritë e shpenzimeve (pa përfshirjen e kategorisë së shpenzimeve Paga & Mëditje), të cilat janë certifikuar dhe aprovuar janë mbi **2856** lëndë për pagesa të cilat kapin shumën prej: **3,152,265.67 €**.

Regjistrimi i të Hyrave Vetanake

Përveç Granteve Qeveritare, Donacioneve të ndryshme dhe burimeve tjera, të Hyrat Vetanake janë burim tejet i rëndësishëm në kontestin e financimit të aktiviteteve të ndryshme komunale.

Pagesat apo pranimet e mjeteve nga qytetarët me rastin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme nga zyrtarët komunal dhe me rastin e pagesave të taksave dhe tatimeve, janë realizuar në dy mënyra:

- a) Pagesat në thezori shuma, e secilës pagesë që ka vlerë nën 10 (dhjetë) euro dhe
- b) Pagesat në llogarinë bankare, shuma e së cilës pagesë që ka vlerë mbi 10 (dhjetë) euro.

Gjatë vitit 2019 nga zyrtarët e DEFZH-së, me azhuritete është bërë arkëtimi i mjeteve nga thezori i Shck-së, Participimet në Shëndetësi (QKMF), të hyrat nga zyret e vendit, të hyrat nga anëtarësia në bibliotekë dhe barazimet me arkëtarët e këtyre thezoreve.

Për çdo ditë janë siguruar raporte ditore nga Sistemi i Free-Balanc-it mbi pagesat e të hyrave vetanake të paguara përmes llogarive bankare, është bërë klasifikimi i të Hyrave për secilën Drejtori veç e veç a mbi pagesat e pranuar nga palë të ndryshme, etj.

Në periudha tremujore është bërë barazimi i rregullt mes zyrtarit të regjistrimit të të hyrave vetanake dhe departamenteve tjera që kanë inkasuar mjete.

Llojet e të hyrave vetanake të cilat janë realizuar gjatë vitit:

Të hyrat direkte:

Tatimi në pronë;
 Taksa nga regjistrimi i automjeteve;
 Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë;
 Gjobat nga inspektorati;
 Licencat pranim teknik të lokalit;
 Taksa komunale për leje ndërtimi;
 Taksa për regjistrimin e trashëgimisë;
 Gjobat nga inspektorati;
 Të Hyrat nga shitja e pasurisë;
 Shfrytëzimi i pronës publike;
 Ndëshkimet ndaj operatorëve ekonomik;
 Taksa për matjen e tokës në teren;
 Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklamat);
 Taksa e Ndërrimit Destinimit të Tokës;
 Taksa për Shfrytëzimin e Resurseve natyrore;
 Shitja e Mallrave - (Masa drusore);
 Taksa e certifikatave të lindjes;
 Taksa e certifikatave të kurorëzimit;
 Taksa e certifikatave të vdekjes;
 Taksa e certifikatave tjera të ofiçarisë;
 Taksa tjera Administrative;
 Taksa për shtetësi;
 Taksa për certifikata mjekësore;
 Licencat pranim teknik të lokaleve;
 Inspektimi i respektimit të planit Urbanistik;
 Inspektimi higjeniko-sanitarë;
 Partecipimet në Shëndetësi;
 Partecipimet në Arsim;

Të hyrat indirekte:

Të hyrat nga gjobat e gjykatave;
 Të hyrat nga gjobat e trafikut;
 Të hyrat nga APK (Pylltaria).

Gjithashtu është realizuar një numër i madh i kërkesave për zotimin e mjeteve përmes dy moduleve dhe atë me modulën e blerjes dhe modulën e aprovimit.

Regjistrimi i Pasurisë Jofinanciare

Bazuar në Rregulloren e MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatatat buxhetore, është bërë regjistrimi i pasurisë jofinanciare (vlera mbi 1000 euro. Investimet kapitale ishin nga më të ndryshmet, duke filluar me rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, rregullimin e ujërave të zeza, rregullimin trotuarëve, rregullimin e urave, rregullimin e ndriçimit publik, investimet në palestrën sportive, rregullimin e ujit të pijshëm si dhe shumë projekte tjera të cilat u investuan dhe u regjistruan si pasuri Komunale.

Në kuadër të bashkëfinancimit të projekteve kapitale me Ministrinë e ndryshme të Republikës së Kosovës, në koordinim me disa prej tyre si: Ministria e Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit, Ministria e Infrastrukturës, etj. Ministrinë financuese dhe janë siguruar dokumentet e nevojshme për regjistrim të këtyre projekteve si pasuri e komunës.

Përgatitja e Buxhetit 2020 – 2021

Për çdo vit me fillim të muajit maj të vitit aktual fillojnë punimet rreth hartimit të Buxhetit komunal për vitet vijuese. Fillimisht pas hartimit të Kornizës Qeveritare Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2020 - 2021 të Ministrisë së Financave dhe sipas udhëzimeve të lëshuara nga Ministria është filluar me fazën e parë të përgatitjes së buxhetit komunal për vitin 2020 dhe vlerësimeve për vitet 2021 – 2022.

Hapat e procesit buxhetor të cilat janë ndjekur gjatë vitit 2019 për përgatitjen e Buxhetit 2020 dhe vlerësimeve për periudhën afatmesme 2021 -2022 kanë qenë:

- 1. Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2020-2022:** Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor.

Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

2. **Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale:** Kryetari i Komunës, ZKF dhe drejtorët e drejtorive komunale bënë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre sektoriale.
3. **Kufijtë fillestarë specifik për programet buxhetore:** Janë vendosur – caktuar kufijtë fillestarë specifik të programeve para datës 01 Korrik 2019.
4. **Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve:** Drejtorët e drejtorive bënë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve, përfshirë politikat e reja si dhe opsionet për kursime të mundshme.
5. **Dëgjimet buxhetore:** Janë organizuar seanca dëgjimore në secilën drejtori komunale me qëllim të shqyrtimit të buxheteve të propozuara si dhe dëgjime publike të hapura me publikun.
6. **Shqyrtimi i buxhetit komunal nga Kuvendi Komunal:** Kryetari i Komunës përmes drejtorisë së Financave ka dorëzuar propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe aprovim.

Aprovimi i buxhetit të propozuar nga Kuvendi Komunal dhe dorëzimi në MF: Propozim buxheti komunal për vitin 2020 dhe vlerësimet për periudhën afatmesme 2021-2022 i aprovuar nga Kuvendi Komunal u dorëzua në Ministrinë e Financave.

Spektori i Tatimit të Pronës

Zyra e tatimit në pronë

Zyra e Tatimit në pronë në bazë të Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2019, me Nr. 01 Nr.05-430/03-

36591/18, ka bërë përgatitjen dhe hartimin e planit për shtypjen dhe shpërndarjen e faturave të tatimit për vitin 2019.

Risi për vitin tatimor 2019 është edhe ngarkimi dhe faturimi edhe i parcelave që ka të bëjë me Ligjin Nr.06/L-005- Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë.

Pos punëve të përditshme Zyra e tatimit në pronë ka filluar shtypjen e faturave tatimore me 10.02.2019 , dhe atë për secilën Zonë Kadastrale, për objekte dhe për parcela, pra për 29 zona kadastrale .

Në vazhdimësi me shtypjen e faturave kemi filluar edhe shpërndarjen e tyre nëpër adresa të pronës e që të njëjtat janë shpërndarë, vlen të theksohet se për shpërndarjen e tyre kemi angazhuar dy(2) punëtor shtesë dhe se faturat janë shpërndarë me kohë.

Menjëherë pas fillimit të shpërndarjes së faturave tatimore, ka filluar edhe procedura e ankesave dhe atë:

- a) Nëse fatura e tatimit në pronë është e pasaktë, vlerësimi i pronës nuk është jo i drejtë;
- b) Ekzistojnë gabime në regjistrat e tatimit në pronë mbi të cilat është bazuar fatura e tatimit në pronë.;
- c) Matje të gabuara;
- d) Normë tatimore e pasaktë, bazuar në shfrytëzimin e pronës;
- e) Zbatimi i gabuar i Ligjit nr. 06/L-005,mbi Tatimin në pronën e paluajtshme.

Gjatë afatit të ankesave për vitin 2019, zyra e tatimit në pronë ka pranuar 121 ankesa dhe atë sipas kategorive të pronës të ndryshme, por gjatë këtij viti ka qenë risi edhe ankesat për parcela që janë bërë departamentit të tatimit në pronë (MEF) ku numri i tyre është 54.

Të gjitha ankesat e arritura janë vizituar në terren nga anketuesit e ZTP dhe janë shqyrtuar brenda afatit ligjor .

Është vazhduar të qëndrojnë e hapur ekspozita “Sa vlen toka juaj” me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me vlerat e tokave të tyre, pasi që në vitin vijues

do të tatimohen edhe për tokat për të cilat nga MF-Departamenti i Tatimit në Pronë kemi marr Raportin mbi vlerësimin e përgjithshëm për komunën tonë e që do të jetë bazë për ngarkimin me tatim.

Gjatë vitit 2019 janë paguar gjithsej 4791 fatura në vlerë prej 293.013,49 € shumë e cila është rritur afërsisht 20% në krahasim me vitin paraprak .

Në fillim të vitit 2019 është hartuar edhe plani i rianketimit, janë rianketuar 1323 prona dhe janë regjistruar 201 objekte të reja. Është zbatuar Udhëzimi administrativ Nr.7/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë. Janë lëshuar një numër i konsiderueshëm i vërtetimeve që kanë të bëjnë me shërbimet e Kadastrave komunale, kërkesa për caktimin e kushteve urbanistike, kërkesave për leje ndërtimi si dhe kërkesa tjera që bëhen në këtë drejtori. Për taksën për regjistrimin e automjeteve motorike kemi lëshuar gjithsej 5210 vërtetime, si dhe për jo tatimpagues dhe për asistencë sociale janë lëshuar 986 vërtetime.

Zyra e tatimit në pronë ka identifikuar edhe tatimpaguesit të cilët nuk janë përgjigjur pagesës së tatimit në pronë dhe për një numër prej tyre (115) iu është dërguar edhe vërejtja e fundit për mos pagesën e tatimit në pronë.

Ky sektor ka kryer punët dhe detyrat e punës të cilat u takojnë ka marrë pjesë në komisione të ndryshme etj.

Sektori i Zhvillimit Ekonomik

Qendra e Regjistrimit të Bizneseve

Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve në Kaçanik(QKRB) për vitin 2019. Gjatë periodës raportuese kjo Zyre ka pranuar 851 lëndë nga të cilat në afatin ligjor ka vendosur të gjitha këto lëndë, nga të cilat:

BIZNESE TË REJA	114
NDRYSHIME NË BIZNES	111
SHUARJE TË BIZNESEVE	08
CERTIFIKATA TË REJA	428
CERTIFIKATA DUBLIKATË	11
INFORMATAT E BIZNESIT	23
PAGESA E TAKSËS NË BIZNES	62

VËRTETIM QË NUK KA BIZNES TË REGJISTRUAR	11
VËRTETIM PËR TENDER	30
AKTVENDIMET E TAKSËS NË BIZNES PËR VITIN 2019	51
VËRTETIM PËR ZGJATJE ORARI	01
VËRTETIM PËR LEJE PUNE	01

Tab.Nr. 7.

Bazuar në objektivat tona strategjike për përkrahjen e bizneseve, janë realizuar një sërë aktiviteteve si:

- Nxitja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM-ve):

Mbështetja e NVM-ve të cilat operojnë në komunën tonë me blerjen e makinerive dhe pajisjeve tjera të punës, mbështetja financiare për pjesëmarrje në panairë për promovimin e produkteve të tyre dhe ofrimin e asistencës – shërbimeve këshilluese, këtu me fokus të veçantë është përkrahja e ndërmarrësve të rinjë që dëshirojnë të zhvillojnë të hapin dhe zhvillojnë biznesin e tyre.

- Aplikimi i lehtësirave për bizneset,

Në këtë drejtim edhe gjatë vitit 2019, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim janë njoftuar të gjitha bizneset dhe iu është ofruar asistencë dhe këshilla për të aplikuar në skemën e Granteve të lansuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe skemës së Granteve të lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjensionit për përkrahjen e bizneseve (NVM) në Kosovë – KIESA.

Këto skema të Granteve kanë si qëllim kryesor mbështetjen e bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese me pajisje pune – makineri.

Në bazë të marrëveshjes së arritur në vitin 2018, kemi vazhduar me realizimin e Projektit “Fuqizimi i Sektori Privat (EMPOWER Privat Sektor)” i financuar nga USAID dhe SIDA Suedeze. Ky projekt tashmë i finalizuar, është implementuar nga komuna e Kaçanikut dhe tri (3) organizatave tjera partnere të kontraktuara nga USAID-i dhe SIDA si: HELP KOSOVO, KPK (Klubi i Prodhuesve të Kosovës) dhe AUK (Universiteti Amerikan në Kosovë).

Me Organizatën "Help Kosova" është zhvilluar projekti "*Programi i Trajnimit për Vetë - Punësim*". Qëllimi i këtij projekti ka qenë nxitja e nivelit të punësimit të rinjëve dhe ndërmarrësinë tek të rinjtë e cenueshëm ekonomikisht dhe të marginalizuar. Për realizimin e këtij projekti komuna ka bashkëfinancuar shumën prej 10,000.00€ apo 22% të shumës së përgjithshme sipas marrëveshjes së mirëkuptimit me Organizatën "Help Kosova". Përmes këtij projekti konform marrëveshjes së arritur mes Komunës Kaçanik dhe "Help Kosova" është realizuar:

1. Ofrimi i trajnimeve të biznesit për 50 të rinjë nga komuna jonë me qëllim të rritjes së aftësive të tyre të bërit biznes dhe shanseve për punësim të qëndrueshëm. Të gjithë vijuesit e këtij trajnimit po ashtu janë pajisur me Certifikata lidhur me aftësitë e fituara.

2. Krijimi i vendeve të punës përmes ofrimit 20 granteve për vetëpunësim për të rinjtë nga Komuna e Kaçanikut të cilët kanë ndjekur trajnimin për biznes. Pra, përveç trajnimeve, janë pajisur me mjete pune të nevojshme 20 përfitues, të gjithë përfituesit me pajisje pune tashmë kanë hapur bizneset e tyre pranë Qendrës për Regjistrim të Bizneseve.

Në kuadër të Memorandum Bashkëpunimit mes Komunës sonë dhe KPK (Klubi i Prodhuesve të Kosovës), ende është duke u zhvilluar projekti "*Trajnimit në Punë*". Përmes këtij projekti i është mundësuar të rinjëve të komunës sonë zhvillimi i mbajtjes së praktikës së punës në disa ndërmarrje prodhuese që operojnë këtu dhe në Komunën e Ferizajt. Me rastin e përfundimit të praktikës së tyre, secili person në bazë të aftësive dhe interesimit të treguar, ka pasur rastin të pozicionohet si punëtor i rregullt në atë ndërmarrje ku edhe ka përfunduar punën praktike.

Ndërsa, në kuadër të Memorandum Bashkëpunimit mes Komunës sonë dhe A.U.K, është zhvilluar projekti "*Programi Trajnues për Zhvillim dhe Punësim Rajonal, RED-T*". Përmes këtij projekti për të rinjtë e Komunës së Kaçanikut dhe me qëllim të aftësimit të tyre për tregun e punës janë organizuar trajnime falas të gjuhëve të huaja (anglisht dhe gjermanisht), trajnime për aftësi komunikuese, marketing dhe shitje në biznes, Modulet bazë ECDL, Zhvillimi i Ueb-faqeve etj.

- Komuna aplikon “zero” taksë për të gjitha bizneset dhe ndërmarrjet me karakter zhvillimor ekonomik dhe rritjen e numrit të vendeve të punës, të rregulluar me rregulloren për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale. Kjo rregullore i liron nga taksa bizneset që ushtrojnë veprimtari me karakter prodhues, si:

a) prodhuesit bujqësor (fermat bujqësore, qumështoret, kultivuesit dhe rritësit e peshqve, prodhuesit dhe përpunuesit e pemëve dhe perimeve, të gjithë prodhuesit e drithërave dhe perimeve,

b) prodhuesit e materialit ndërtimor, të paketimit, lëngjeve, mobiljeve, metaleve, elementet e plastikës, aluminit dhe prodhuesit e tjerë me interes shoqëror,

c) industria përpunuese – prodhuese (e drurit, metalit, ngjyrave, ushqimit – mishit, zdrukthëtarisë) etj.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës i Kaçanikut, ka marrë vendim për aprovimin e Rregullores 01.Nr.16-32118/2016 për caktimin e normave të reja të tatimit në pronë për bizneset, duke i ulur normat tatimore edhe më tutje, çka në këtë mënyrë është njëra nga komunat me tatimin më të ulët në pronë në tërë Kosovën. Pra, për të gjitha pronat në shërbim të afarizmit aplikohet norma vetëm 0.18%, ndërsa për objektet tjera, si ato të banimit, aplikohet norma 0.20%.

Inspektoriati i Tregut

Përgjatë vitit 2019 janë kryer këto punë:

- Inspektime për parandalimin e ekonomisë jo formale 142
- Pranime teknike30
- Aktvendime14
- Urdhëresa62
- Hapje të procedurës kundërvajtëse 3 në shumë (700€)
- Gjoha mandatore 7 në shumë(1800€)
- Njoftim dhe shkresa zyrtare.....6

- Intervenime rreth vendosjes së orarit të punës dhe mbishkrimit të firmës19
- Plan operativ për mbikëqyrjen e respektimit të kujdestarisë së natës nga Barnatoret Farmaceutike- Inspektim gjatë natës;
 - Inspektim së bashku me Inspektorët e ATK-së ,MTI-së dhe Krimet Ekonomike ku janë shqiptuar edhe gjoba mandatore të cekur më lartë;
 - Plani Operativ lidhur me transportin e mallrave pa dokumente - Inspektimet janë kryer së bashku me Inspektorin Sanitar dhe Policinë;
 - Dalja dhe kontrollimi rreth respektimit të orarit të punës edhe gjatë natës në bashkëpunim me policinë;
 - Inspektim i subjekteve të cilat veprojnë me karburante lidhur me licencat për gaz dhe karburant si dhe dokumentacionet tjera;
 - Inspektim rreth zbatimit të ligjit për duhan;
 - Largimi duhanit nga shitja ne vende te ekspozuara;
 - Largimi i të gjitha produkteve ushqimore dhe jo ushqimore të ngjashme me duhanin;
 - Inspektimi i vendosjes së deklaracionit të artikujve ushqimorë;
 - Largimi i shitësve ambulant;
 - Kontrollimi i të gjitha furrave të bukës në Komunën e Kaçanikut si dhe matja e peshës së bukës;
 - Kontrollimi i vendosjes së çmimeve për artikujt ushqimor;
 - Kontrollimi i cilësisë së mallit me Inspektorin sanitar dhe konfiskimi i mallit.

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Vitin 2019 DUKMM e përmbyll me realizimin e projekteve të cilat ishin të planifikuar si projekte kapitale. Zgjerimi i rrugës "Avdurahim Shehu" në të cilën është punuar në zgjerimin dhe vendosjen e mureve mbrojtëse, vlen të theksohet se ky projekt për fazën të cilën e kemi punuar mundë të konsiderohet shumë i suksesshëm për arsye të specifikave të cilat kanë qenë, një rrugë shumë e ngushtë dhe me rrëshqitje të vazhdueshme të një pjese të sajë këtu duhet të falënderohen edhe disa nga pronarët të cilët kanë lëshuar pronat e tyre që të zgjerohet rruga, në pjesën ku kjo rrugë ka pasur rrëshqitje është bërë pilotimi i sajë më pilotë 12m dhe tani konsiderojmë se kjo pjesë është stabilizuar. Ky projekt vazhdon me zgjerim, kanalizim, shtrirjen e ujësjellësit deri te SANITEKSI, ndërtimin e trotuarit dhe asfaltim.

Projekti i rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të Qytetit ky projekt është realizuar prej hyrjes së qytetit d.m.th. prej aty ku lidhemi me magjistralen Kaçanik - Ferizaj, është zgjeruar hyrja, është ndërtuar muri mbrojtës është ndërtuar rreth rrotullimi te Qendra e shkollës së mesme "Skënderbeu" është bërë e mundur rreshtimi i Automjeteve pasi është zgjeruar rruga, pasi është hequr muri për rreth parkut është ndërtuar trotuari me gjerësi 4 m është vendosur vendkalimi me standardet e nevojshme është përgatitur infrastruktura nëntokësore për rrymë, telefon duke u vendosur 6 gypa nëntokësore në bazë të projektit të marruar nga KEDS-i, është ndërruar komplet gypi i Ujësjellësit prej kyçjes te Stacioni i Autobusëve deri te ura me gyp të standardeve të fundit. Është vendosur edhe she njëzimi komplet dhe mbrojtëset me zinxhir për rreth trotuarit, pra është ndryshuar komplet pamja e qytetit prej hyrjes.

Një projekt që është kryer është edhe largimi i Deponive Ilegale, problemi më madhor në komunën tonë prej viteve në vite e kemi këtë problem që na përsëritet kemi larguar 10 deponi, dhe shpresojmë se kjo dukuri të vjen duke u zvogëluar pas përmirësimit të grumbullimit të mbeturinave nga Kompania Pastërtia.

Kemi sanuar shtratin e lumit Nerodime për shkak të dëmtimeve që kanë qenë në derdhjen e sajë, dhe dëmtimit të cilat ishin shkaktuar më herët në muret ekzistuese, projekt i cili do të vazhdojë.

Në kuadër të DUKMM-së, kemi pasur edhe projektin e rrugëve lokale ku janë ndërtuar disa rrugë, disa janë zgjeruar disa edhe kanë përfunduar mbasi edhe janë asfaltuar dhe shumë të tjera të cilat janë përgatitur për asfaltim.

Gjatë këtij viti projekti për fazën e parë për rrugën e Semajës është realizuar në pjesën e parë të vitit, ndërsa fatmirësisht kemi arritur që ta realizojmë edhe fazën e dytë në pjesën e dytë të vitit.

Projekti 'Hartimi i Projekteve' është realizuar për këtë vit, projekti i kanalizimit për fshatin Begracë, projekti i fushës së futbollit me bari natyral, projekti i ndriçimit në Kaçanik, projekti rrugëve të Qytetit etj.

Këtë vit, ka filluar edhe procesi i legalizimit të objekteve të cilat janë ndërtuar pa leje, të gjithë ata që kanë aplikuar janë duke u shqyrtuar dhe disa veç i kemi përfunduar dhe kanë marrë edhe lejet e legalizimit.

Janë lëshuar edhe leje ndërtimore të kategorive të ndryshme, disa edhe janë biznese të cilat kanë filluar të punojnë me sukses në Kaçanik.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) të cilin kemi filluar ta përpilojmë është një punë voluminoze që është bërë duke u falënderuar zyrtareve komunal të të gjitha sektorëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm që i kemi angazhuar dhe mund të thuhet se është duke u përpunuar me të gjitha kapacitetet. Është përfunduar profili, por kemi akoma punë për të studiuar dhe analizuar në këtë drejtim.

Këtë vit kemi pasur edhe ndarjen e parcelave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale afatgjatë për 99 vite për biznese. Ne si drejtori, kemi ndarë parcelat dhe i kemi proceduar e që shpresojmë në realizimin e këtyre bizneseve në bazë të projekteve të ofruara. Gjithashtu kemi bërë ndarjen e një parcele për shfrytëzim zyrës për punësim ku ka filluar edhe ndërtimi i objektit shumë të nevojshëm për këtë departament.

Në vitin 2019 na kanë përcjell sfida të shumta me padi në Gjykatë për shkak të rrugëve të cilat janë asfaltuar dhe pretendimit të pronarëve se janë tjetërsuar pronat pa pëlqimin e tyre, disa nga rrugët pasi i kemi kryer matjet, kemi në procesin e shpronësimit duke i përgatitur elaboratet dhe janë në procedura, disa me marrëveshje, ndërsa disa janë akoma në proceset Gjyqësore.

Kemi përgatitur dokumentacionin komplet për zonat që i kemi shpallur si zona me interes komunal dhe i kemi dorëzuar në ministri për të fituar të drejtën e bartjes në emër të komunës dhe presim që ky proces të përfundojë sa më parë në mënyrë që ne të mund të krijojmë hapësirë për investitorët të cilët tani veç po paraqiten për investime të mundshme.

DUKMM-ja është e kënaqur me shërbimet të cilat i ka kryer për qytetarët duk iu ofruar shërbim në të gjitha lëmitë përkatëse duke përfshirë bizneset dhe investitorët të cilët kanë pasur një tretman të veçantë duke i eliminuar të gjitha barrierat burokratike për të kryer sa më shpejt punët që synoheshin.

Jemi në përgatitjen e projektit të qarshisë ku planifikohet të ndërtohen objekte me arkitekturë të veçantë të stilit klasik. Pastaj do të shikojmë mundësitë ligjore që lokalet e ndërtuara me i dhënë në shfrytëzim, po ashtu jemi duke punuar me disa kompani të cilat kanë projekte për trajtimin e ujërave të zeza dhe trajtimin e mbeturinave. Kemi ndërmarrë masa edhe në mbrojtjen e ambientit, sidomos me ndotësit më të mëdhenj siç është "Silkapor" etj, duke i proceduar edhe në Gjykatë.

Po ashtu në kuadër të projektit të DUKMM-së, "Rregullimi dhe asfaltim i rrugëve lokale" janë implementuar edhe 9 rrugica tjera me shtresë asfalti dhe kubëza si në vijim:

NR.	EMËRTIMI	GJATËSIA/M	GJERËSIA/M ²
1.	Rruga "Kadri Dullovi"-Biçec	156m	624m ²
2.	Rruga "Adem Jashari"-Stagovë/ te stadiumi	341m	1705m ²
3	Shtrimi me kubëza i degëzimit të rrugës "Mejdi Dalloshi"-Kaçanik	32m	104m ²
4	Shtrimi me kubëza i degëzimit të rrugës "Sali Bajra"-Kaçanik	123m	413m ²
5	Shtrimi me kubëza i degëzimit të rrugës "Muhamet Zeneli"- Bob	63m	259.5m ²
6	Shtrimi me kubëza i rrugicës "Hamdi Asanraka"-lagjja Rakë-Koxhaj	70m	282m ²
7	Shtrimi me zhavor i rrugicave në lagjen Dalloshi-Soponicë	Përgatitja e traseve për asfaltim	Përgatitja e traseve për asfaltim
8	Asfaltimi i rr. "Ekrem Ahmetaj"-Kovaçec	520m	1560m ²
9	Shtrimi me kubëza i degëzimit të rrugës "Vëllezërit Dema"-Bob	58m	222.73m ²
Total:		1363m	3760.23m²

Tab. Nr. 8.

DREJTORIA E EMERGJENCAVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka për qëllim të raportimin për Kryetarin e Komunës, komitetit për Shërbime Publike si dhe informimin e opinionit publik për punën e DSHPE-së për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Është raport përmbledhës dhe njëherit paraqet punët e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit.

Të gjitha aktivitetet e poshtëshënuara janë realizuar në bashkëpunim të plotë me kryetarin e komunës dhe drejtoritë tjera të ekzekutivit komunal.

Infrastruktura rrugore

Asfaltime të rrugëve lokale

Drejtorja e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike në kuadër të përgjegjësisë dhe aktiviteteve të saja edhe gjatë vitit 2019 fokus të veçantë i kushtoi realizimit të projekteve kapitale brenda listës së miratuar nga projekt buxheti për investime kapitale për vitin 2019 i miratuar nga kuvendi komunal dhe projekteve kapitale të përfituara në bashkëfinancim me ministritë e ndryshme. Në bashkëpunim me zyrën e kryetarit dhe të drejtorive tjera është angazhuar për implementimin e projekteve të infrastrukturës rrugore të cilat janë paraqitur si vijon:

- Asfaltime dhe ndërtime të rrugëve lokale nga buxheti i komunës:

Gjatë kësaj periudhe, nga lista e investimeve kapitale me buxhetin e komunës janë realizuar gjithsej **17** projekte rrugësh të asfaltuar dhe ndërtuar me kubëza, ku gjatësia e rrugëve të ndërtuara arrin **17,227m**.

NR.	EMËRTIMI	GJATËSIA/M	GJERËSIA/M ²
1	Asfaltim i rrugës “Beteja e 25 Majit”-Dubravë;	810m	4050m ²
2.	Ndërtimi i rrugëve në Begracë;	1230m	3690m ²

3	Ndërtimi i rrugëve në Kaçanik të Vjetër;	1911m	5733m ²
4	Ndërtimi i rrugëve në Ivajë-rruga "Beteja e Ivajës";	230m	890m ²
5	Asfaltimi i rrugës në lagjen Tushaj-Soëonicë;	565m	1695m ²
6	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kotlinë;	1100m	5500m ²
7	Ndërtim i rrugëve në fshatin Stagovë;	858m	2574m ²
8	Asfaltim i rrugës "Terziu"-Doganaj;	770m	3080m ²
9	Rregullim i rrugës "Shaban Elezi"-Sllatinë;	1100m	4400m ²
10	Ndëtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Gllboqicë;	1320m	3960m ²
11	Ndërtimi i rrugëve në lagjen Shehler-Doganaj;	530m	2120m ²
12	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biçec;	1207m	4828m ²
13	Rregullimi i rrugëve në fshatin Kovaçec;	570m	1910m ²
14	Asfaltim i rrugës Koraq-Mezin/Bunjak;	675m	2700m ²
15	Rregullim i rrugëve në fshatin Gajre;	1395m	4580m ²
16	Rregullimi rrugëve ne lagjet Prushaj-Lamaj/Soëonicë;	2,956m	9,975m ²
	Total	17,227m	61,688m²

Tab. Nr. 9.

Ndërtim dhe asfaltime të rrugëve lokale nga Ministria e Infrastrukturës 2019

Ministria e infrastrukturës dhe komuna e Kaçanikut kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit për realizimin (3) katër projekteve te reja për vitin 2019.

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m	Gjërësia/m ²
1.	Asfaltimi i rrugës "Çamëria" Bajnicë-Rakaj;	3,050m	14,000 m ²
2.	Asfaltimi i rrugës "Triumf Riza"-Stagovë;	3266m	11,628 m ²
3	Ndërtimi i rrugës "Idriz Seferi"-Kaçanik;	325m	2500 m ²

Total

6,641m

28,128m²

Tab.Nr.10.

Asfaltim dhe rregullim i rrugëve nga Ministria e Infrastrukturës 2018-2019

Ka vazhduar implementimi edhe 7 projekte në infrastrukturën rrugore dhe (1)një projekt i ndërtimit të urës në bashkëfinancim me MI-në në kuadër të memorandumit të vitit 2018-2019.

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m	Gjërësia/m ²
1.	Asfaltimi i rrugës në lagjen Trupaj-Kovaçec;	760m	3,040 m ²
2.	Asfaltimi i rrugës "Veli Dema"-Bob;	211m	847 m ²
3	Rruga"Man Dashi"-Stagovë;	400	1,200 m ²
4	Rruga"Adem Dullovi"-Vataj /përgatitja e trasesë së rrugës;	312	936 m ²
5	Rruga"Xhevë dhe Fehmi Ldrovci-lagjja Kok /Runjevë;	220	660 m ²
6	Rruga e lagjes Brruti-Kaçanik;	230	690 m ²
7	Rruga"Arbëria"-Kaçanik;	210	630 m ²
8	Ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc-fshati Kovaçec;	40m	240 m ²
Totali:		2,383m	7,400m²

Tab.Nr. 11.

Implementimi i projekteve nga Granti i Performancës:

Nga Granti i Performancës së vitit 2018 kemi përfituar 50,000.00€, të cilat janë përdorur për implementimin e projektit "Rregullimi i ndriçimit publik"-ku komuna ka bashkë financuar në vlerën 43,380.00€.

NR.	EMËRTIMI	GJATËSIA/M	NR. I TRUPAVE NDRIÇUES
1	Rregullimi i ndriçimit publik	12895m	322 trupa ndriçues

Tab. Nr. 12.

Ujësjiellësi

Rregullimi i sistemit aktual të ujësjiellësit dhe ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjiellësit

Gjatë vitit 2019 është vazhduar me finalizimin e projektit **“Sanimi, rekonstrumi dhe shtimi i kapaciteteve ujore për sistemin e ujësjiellësit Nikaj, Dubravë, Doganaj, Elezaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër”**. Janë punuar rrjet furnizuese në drejtim të fshatrave dhe lagjeve të fshatit Dubravë (lagjet :Vishaj, Vataj, Imisht, Hajdaraj, Rekë, Memaj); Soponicë (lagjet: Dallosh, Kovaç, Tushaj, Demnik, Provoli); Elezaj, Terziu, Doganaj dhe Koxhaj, si është vazhduar vendosja e gypit në drejtim të fshatit Kaçanik i Vjetër.

- Në kuadër të projektit **“Ndërtimi i rrugëve të qytetit”** dhe **“Rregullimi i rrugës “Idriz Seferi”** është bërë ndërrimi i gypave të rrjetit të ujësjiellësit nga materiali i asbest-betonit me gypa polietileni në gjatësi **349.5m** (Rr. Idriz Seferi) dhe **250m** (në Rr. Agim Bajrami).
- Po ashtu në bashkëpunim me KRU “Bifurkacioni”-njësia operative në Kaçanik është shtrirë dhe funksionalizuar rrjeti i ujësjiellësit në lagjen Kukaj-Bob dhe Mezraj-Kovaçec.

Kemi arritur që me mjetet buxhetore të komunës të realizojmë projektin **“Furnizimin me gyp të ujësjiellësit”**. Janë siguruar **3300m** gyp $\Phi 63$ për nevojat e rrjeteve të ujësjiellësit në komunën tonë.

Kanalizimet

Ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimeve- Në kuadër të kodi buxhetor **“Ndërtim i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”** -janë realizuar 13 projekte në ndërtim të kanalizimeve fekale në gjatësi totale **=10,481m**, si dhe kemi bërë furnizim me gyp të kanalizimit fekal dhe atmosferik në gjatësi **2561m**, me vlerë të përgjithshme të projektit=**100,000.00€**.

Nr.	Emërtimi i projektit	Gjatësia
1	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Semajë;	4,364m
2	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Gllaboçicë;	3,511m
3	Ndërtim i kanalizimit fekal në lagjen Çardak-fshatin Kaçanik i Vjetër;	250m
4	Ndërtim i kanalizimit fekal në rrugën Remzi Zharku’ -Dushkajë;	260m
5	Ndërtim i kanalizimit fekal në rrugën “Beteja e Ivajës” -Ivajë;	166m

6	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Llanishtë;	640m
7	Ndërtim i kanalizimit fekal në rr. "Mbretresha Teutë"-K.Vjetër;	520m
8	Ndërtim i kanalizimit fekal te ambulanta e re në K.Vjetër;	230m
9	Ndërtim i kanalizimit fekal ne lagjen Koraq-Kovçec;	100m
10	Ndërtim i kanalizimit fekal në Rr. "Kadri Trena"-Kaçanik;	70m
11	Ndërtim i kanalizimit fekal në Dushkajë;	90m
12	Ndërtim i kanalizimit fekal te Qerdhja e Vjetër-Kaçanik;	50m
13	Sanim dhe ndërtim i kanalizimit fekal në rr."Asdreni"-K.Vjetër;	230m
	Totali	10,481m
Furnizime me gypa për kanalizime fekale dhe atmosferike		
1	Furnizim me gypa të kanalizimit atmosferik te varrezat në K.Vjetër;	202m
2	Furnizim me gypa të kanalizimit fekal ne fshatin Gajre;	204m
3	Furnizim me gypa të kanalizimit në fshatin Gërlicë e Epërme;	786m
4	Furnizim me gypa të kanalizimit fekal në Stagovë-lagjja Dashi;	216m
5	Furnizim me gypa të kanalizimit fekal në fshatin Duraj;	282m
6	Furnizim me gypa të kanalizimit fekal në Bajnicë;	156m
7	Furnizim me gypa të kanalizimit në lagjen Troni-Kovçec;	108m
8	Furnizim me gypa të kanalizimit në lagjen Vishaj;	30m
9	Furnizim me gypa të kanalizimit ne lagjen Tafili-Kaçanik;	18m
10	Furnizim me gypa të kanalizimit ne fshatin Koxhaj;	104m
11	Furnizim me gypa të kanalizimit për nevoja të rrjeteve të reja të kanalizimeve;	455m
	Total	2561m
	Rehabilitim i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në Kovaçec, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Begracë, Bob dhe Dushkajë	200m

Tab.Nr. 13.

- Ndërtim i kanalizimit fekal në kuadër të projektit "Ndërtim i rrugës "Idriz Seferi"-Kaçanik janë ndërtuar **106m** rrjet i kanalizimit fekal. Në total gjatë vitit 2019, janë realizuar **10,457m** rrjet të kanalizimit fekal dhe janë siguruar **2,561m** gyp për rrjete të kanalizimit fekal dhe atmosferik te komunitetet që kanë ekzekutuar punimet me vetëfinancim.

Ujërat sipërfaqësore

Gjatë këtij viti kemi investuar në ndërtimin e disa rrjeteve të ujërave atmosferike. Kemi ndërtuar rrjetin e kanalizimit të ujërave atmosferike dhe ndërtim të shtretërve të përrockave në gjatësi **700m** të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese:

Emërtimi	Gjatësia
Rregullimi i përrockës në Bob	100m
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik në rr, "Agim Bajrami" dhe rr. "Idriz Seferi"-Kaçanik	600m
Totali	700m

Tab.Nr. 14.

Menaxhimi i Mbeturinave

Edhe gjatë këtij viti jemi fokusuar në implementimin dhe realizimin e objektivave të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021.

Jemi fokusuar në implementimin e projektin **"Furnizimit me shporta për mbeturina 120l"**. Vitin e kaluar janë siguruar gjithsej 2300 shporta 120l, projekt në vlerë **40,250.00€**. Këto shporta janë shpërndarë ekonomive familjare të reja dhe atyre ekzistuese që nuk kanë qenë të furnizuara më parë me qëllim të rritjes së mbulueshmërisë së territorit të komunës sonë me grumbullim dhe menaxhim të mbeturinave.

Po ashtu është implementuar projekti i blerjes së (3)tre automjeteve për KRM "Pastërtia"-njësia operative në Kaçanik, për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, projekt në bashkëfinancim me GIZ-in dhe KRM "Pastërtia" në vlerë **45,000.00€**, ku Komuna e Kaçanikut ndau **23,000.00€** për këtë projekt.

Nga organizata gjermanë "GIZ" në kuadër të programit "Shërbime të Qëndrueshme Komunale"- kemi përfituar si donacion **84 kontejnerë 1.1m³ dhe 700 shporta për mbeturina 120l**, të cilat do të shpërndahen ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve komunale.

Komunikacioni Rrugor

Shenjëzimi Horizontal dhe Vertikal

Gjatë vitit 2019, kemi projektuar dhe realizuar projekte të shenjëzimit horizontal dhe vertikal në disa rrugë të territorit të komunës së Kaçanikut. Është bërë shenjëzimi i rrugëve në hyrje të qytetit, punimi i rreth-rrotullimit në kuadër të projektit **"Ndërtim i rrugëve të qytetit"**, shenjëzimi i vend parkingjeve për autotaksi dhe te banesa P+8, si dhe vendosja e shenjëzimit horizontal dhe vertikal në rrugën **"Çamëria"**-Bajnicë/Rakaj.

Po ashtu janë vendosur barriera për ngadalësim të shpejtësisë (policë të shtrirë) dhe pahi elastike në rrugët lokale ku është evidentuar me rrezikshmëri të lartë.

Është kontraktuar kompania për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal për periudhën trevjeçare 2019-2022, ku planifikohen të realizohen një mori projektesh dhe mirëmbajtje e sinjalizimit aktual.

Hapësirat Publike

Gjelbërimi dhe Parqet

Në kuadër të projektit **“Rregullimi dhe ndërtimi i parqeve publike”** është bërë rregullimi i hapësirës së gjelbëruar dhe parkingut te banesa P+8 në qendër të qytetit.

Vlera e projektit ka qenë **8,125 euro**. Hapësira e rregulluar është 560m².

Po ashtu është ndërtuar hapësira e gjelbëruar përgjatë murit të Kalasë së qytetit dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në hapësira publike dhe në parkun e qytetit.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave

Gjatë vitit 2019 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i varrezave të dëshmorëve, posaçërisht çdo datë të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjtë dekorativ. Gjithashtu është mbështetur komuniteti i fshatit Kaçanik i Vjetër me gypa për ujëra atmosferik dhe zhavor me rastin e rregullimit të varrezave të këtij fshati nga komuniteti.

Trotualet

Gjatë vitit 2019, në kuadër të investimeve kapitale janë ndërtuar edhe 3 projekte të trotuarëve për këmbësor me një gjatësi totale 2,597m.

Nr.	Emërtimi i projektit	Gjatësia/m
1.	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Bajnicë;	450m
2.	Ndërtimi i trotuarit Bob-Doganaj-faza I;	1652m

3.	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Biçec;	495m
TOTALI		2795m

Tab. Nr. 15.

Ndërtim i urave të reja

Po ashtu është bërë ndërtimi i (2) dy urave të reja mbi lumin Nerodime dhe Lepenc (K.Vjetër dhe Kovaçec), si dhe është implementuar projekti i rregullimit të stazës për këmbësor në urën e Konakut.

Nr.	Emërtimi i projektit	Gjatësia
1.	Ndërtimi i urës mbi lumin Nerodime-K.Vjetër;	15m
2.	Ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc-fshati Kovaçec;	40m
3.	Rregullim i stazave për këmbësor (Ura e Konakut);	25m

Tab.Nr. 16.

Ndriçimi Publik

Investime në rrjete të reja

Projekti kapital **“Rregullimi i ndriçimit publik”**, projekt në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit me MAPL-në, ku janë përfshirë mjetet e fituara nga Grandi i Performancës së vitit 2018 në shumë **50,000.00€** dhe mjetet e planifikuara nga buxheti i komunës në shumë **43,380.00€** është ekzekutuar në këto lokacione:

Nr.	Emërtimi i projektit	Gjatësia/Nr.trupave
1.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. “Besnik Begunca”-Runjevë;	1620m/41 trupa
2.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr.“Beteja e 25 majit”-Dubravë;	2450m/77 copë
3.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. “Komandant Bardhi”-Kaçanik i Vjetër;	2485/84 copë
4.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr.“10 Gushti”- Bajnicë;	1685m/36 copë
5.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr.“Raif Krivanjeva”-Kaçanik;	650m/15 copë

6.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. "Tefik Raka"- Kaçanik;	1150m/21 copë
7.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. "Izahir Troni"- Kovaçec;	1550m/23 copë
8.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. "Shaqir Kuka"- Kukaj;	450m/10 copë
9.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. "Jehona Raka"- Dushkajë;	320m/9 copë
10.	Rregullimi i ndriçimit publik në rr. "Ejup Dushkaja"-Dushkajë;	535m/6 copë
Total		12895m/ 322 copë

Tab.Nr. 17.

Mirëmbajtje e rrjeteve ekzistuese

Po ashtu gjatë këtij viti është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik për periudhën (3) trevjeçare, ku jemi angazhuar në mirëmbajtjen e ndriçimit aktual dhe zgjerimit në disa pjesë të lagjeve urbane të qytetit. Edhe gjatë këtij viti, kemi dhënë pëlqime për rregullimin dhe shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në lagjen dhe fshatrat ku komuniteti është shprehur i gatshëm të vetëfinancoi projektin. DSHPE-ja pas implementimit të projekteve ka marrë përsipër shpenzimet mujore të energjisë elektrike në këto rrjete. Kemi dhënë pëlqime për rregullim të ndriçimit publik në:

- Lagjja Shorra- Biçec;
- Lagjja Reqi- Kaçanik i Vjetër;
- Rruga "Liria"- Gërlicë e Epërme;
- Rruga kryesore- Fshati Shtrazë.

Dekorimi i qytetit

Për festat e fund vitit është kontraktuar kompania për dekorimin e qytetit, ku me këtë rast janë bërë dekorime në bulevardin e qytetit dhe në parkun e qytetit.

Vlera e projektit është 9700€.

Mirëmbajtja e rrugëve lokale

Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2019

Gjatë vitit 2019, DSHPE-ja është angazhuar në vazhdimësi në realizimin e kontratës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve lokale gjatë sezonës verore dhe dimërore. Krahas mirëmbajtjes rutinë, gjatë kësaj kohe si (largimi i dheut nga rrëshqitjet, mbushja e gropave me shtresë asfalti, pastrimi i kanaleve të ujërave atmosferike, ndërtim i mureve mbrojtëse, largimi i borës, hedhja e kripës industriale, etj), janë bërë edhe rehabilitime të dukshme të rrugëve me shtresë zhavori dhe shtresë të re asfalti.

NR.	EMËRTIMI	GJATËSIA	GJËRËSIA/M ²
1.	Shtrimi me shtresë asfalti i rrugës "Ismajl Raka";	30m	180m ²
2.	Rehabilitimi me shtresë zhavori i rrugës ka "Teqja";	1200m	4800m ²
3.	Rehabilitimi me shtresë zhavori i rrugës së lagjes Teneqja- Stagovë;	1300m	5200m ²
4.	Rehabilitimi me shtresë zhavori i rrugës "Veteranët 1999"-Ivajë;	200m	800m ²
5.	Rregullimi i trasesë së rrugës "Beteja e 25 Majit"- lagja Provoli/Soponicë;	550m	2750m ²
6.	Shtrimi me shtresë asfalti i hyrjes së rrugës "Dëshmorët e Kombit"-Dushkajë;	95m	570m ²
7.	Rregullimi i rrëshqitje së trasës së rrugës në lagjen Kamishi-Rekë;	26m	104m ²
8.	Shtrimi me shtresë asfalti i rrugës "Qamil Ilazi" dhe "Hasan Prishtina"-Kaçanik;	170m	1020m ²
9.	Shtrimi me shtresë zhavori i rrugicave në lagjen Vishaj dhe Hajdari;	370m	1480m ²
10.	Shtrimi me shtresë zhavori i rrugicave në lagjen Kukaj;	462m	1848m ²
11.	Shtrimi me shtresë zhavori i rrugicave në Kashan- Gjurgjedell;	873m	3492m ²
12.	Rehabilitimi me shtresë zhavori i rrugicave në fsh. Nikaj;	960m	3840m ²
	Total:	6,236m	27,704m²

PASTRIME TË PËRROCKAVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE

Pastrim i shtretërve të përrockave (te Viva dhe te fabrika e thasëve)-Bob;	175m
Pastrimi i deponisë së materialeve inerte në fshatin Gabrricë;	140 ari sipërfaqe

Tab.Nr.18.

STATISTIKA

1	Ndërtim dhe asfaltim të rrugëve lokale	26,251m/97,216m ²
2	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale	10,481m
3	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike	700m
4	Ndërtim i trotuareve për këmbësor	2,795m
5	Riparimi i rrugëve lokale të asfaltuara	295m/1770m ²
6	Rehabilitimi i rrugëve publike të pakategorizuara me shtresë zhavori	5941m/25,930m ²
7	Rregullimi dhe ndërtimi i parqeve publike	1 projekt/560m ²
8	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	3 projekte
9	Rregullim i ndriçimit publik	12,892m/322 trupa ndriçues
10	Ndërtim i urave mbi lumin Lepenc dhe Nerodime	2 projekte
11	Furnizim me gyp ujësjellësi Φ 63	3300m
12	Furnizim me gyp për kanalizime fekale dhe atmosferike Φ200, Φ250 dhe Φ315	2,561m
13	Ndërtim i mureve mbajtëse	2 projekte
14	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit	3 projekte
15	Furnizim me automjete për grumbullim të mbeturinave komunale	1 projekt
16	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	1 projekt
17	Furnizim me kontejnerë për mbeturina 1.1m ³	84 copë
18	Furnizim me kontejnerë për mbeturina 120 l	700 copë
19	Rregullim i shtretërve të përrockave	100m
20	Rehabilitim i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik	200m

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Shqyrtimi i kërkesave, mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti komunës

Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët si dhe për vendosjen e kërkesave të tyre, qytetarët janë informuar me kohë.

Gjithashtu kjo drejtori është angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve me mjete nga buxheti komunës, nga projektet e realizuara kanë përfituar **253** fermerë:

Nga projekti mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m² kanë përfituar 57 fermerë, shuma e mjeteve **22,543.50€**, 20 % participim i fermerëve **4,560.00€**.

Nga projekti për mbështetje të fermerëve me centrifuga elektrike kanë përfituar 33 bletarë, vlera projektit **16,170.00 €**, participimi i fermerëve **3,234.00€**, nga projekti për mbështetje të fermerëve me fidane të arrës dhe lajthisë kanë përfituar 36 fermerë), vlera projektit **7,229.50€**, participimi i fermerëve **1,445.00€**.

Nga projekti për mbështetjen e fermerëve për mbjellje vjeshtore – grurë, kanë përfituar 127 fermerë, të cilët janë mbështetur prej **75-150 €**, varësisht prej sipërfaqes së mbjellë, vlera e projektit **18,234.00€**.

Këtë vit kemi realizuar edhe projektet për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Rekë. Vlera e projektit **14,827.80€**, si dhe ndërtimi i kanalit të ujitjes nga seperacioni në gjatësi 1100m. Vlera e projektit **28,372.80 €**.

Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 27 kërkesa, prej të cilave janë të miratuara 18, të refuzuara 4, në proces për shqyrtim janë 5.

Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është 7500 m². Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej **5,724.00 €**.

Janë shqyrtuar 21 kërkesa të natyrës së ndryshme prej të cilave 16 janë miratuara dhe 5 të refuzuara.

Me kërkesë të palëve janë lëshuar 57 vërtetime lidhur me numrin e koshereve me bletë që posedojnë bletarët, për aplikim në subvencionet e MBZHRP dhe 6 vërtetim e fermerëve si dëshmi që merren me bujqësi me ç'rast janë inkasuar 630 €.

Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale

Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike për temat e shtjelluara nga trajnimet e organizuara gjatë vitit 2019, 11 trajnime gjithsejtë 260 fermerë. Trajnimet janë organizuar me këto tema, të cekuara më poshtë me numër pjesëmarrësve siç vijon:

1. Mbarështimi i kafshëve (të ushqyerit e lopëve qumështorë ,viçave) (69);
2. Praktikat e mira të mjeljes, ruajtjes së cilësisë së qumështit (15);
3. Menaxhimi i fermës (16);
4. Marrja e mostrave të dheut, komentimi i rezultateve dhe rekomandimi për dozat e plehërimit të plehrave (41);
5. Ujitja dhe plehërimi i perimeve (15);
6. Mbrojtja e integruar e perimeve (15);
7. Kultivimi i grurit, roli dhe rëndësia e farës cilësore për mbjellje në prodhimtarinë bimore (32);
8. Vjelja e frutave për konsum dhe përpunim industrial- (17);
9. Të rinjtë në Agrobiznes -(8);
10. Krasitja e gjelbërt e pemëve (16);
11. Kriteret për ngritjen e pemishteve të reja të arrës dhe lajthisë (16);

Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ- ve

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria e BZHRP-së, ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore lidhur me organizimin e trajnimeve në fushën e bujqësisë.

Bashkëpunimi me MBPZHR-së ka qenë kryesisht në implementimin e projekteve të Ministrisë BPZHR siç janë:

Projekti i shërbimeve këshillimore, projektet për subvencionim të fermerëve për lopë qumështore, kafshë të imëta (dele, dhi), bletë, projektet për subvencionimin e mbjelljeve pranverore, vjeshtore, subvencionimin e kulturave perimore, pemëtare dhe në projekte për aplikim në grante. Të gjithë fermerëve të cilët kanë

qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim në subvencionet dhe grantet që ka ofruar MBPZHR. Të gjitha aplikacionet e fermerëve për subvencione janë pranuar në zyrën e DBZHRP-së, të cilat të kompletuara janë dorëzuar në MBPZHR.

Nga projektet e MBPZHR për subvencionim, në komunën tonë kanë aplikuar 333 fermerë, disa prej tyre veçse kanë pranuar subvencionet e disa janë në proces për pagesë.

Mbrojtja e pyjeve nga prerja ilegale

Rojet e pyllit dhe stafi i sektorit të pylltarisë, janë angazhuar për pengimin e dëmtimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegal të masës drusore.

- Janë konfiskuar **69.02m³**, apo shprehur në metër hapësinor **98.69 (mh)** prej kësaj mase drusore 50%, sipas marrëveshjes i takojnë Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SHIL) ndërsa pjesa prej 50% e masës drusore të konfiskuar do të ndahen shkollave.
- Janë ngritur **180** fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje **163 dhe 17** për vepër penale.
- Në bashkëpunim me Policinë dhe Gjykatën, janë sekuestruar mjete të transportit ilegal të drunjtëve siç janë Traktorë dhe Mjete tjera transportuese në kohë të caktuar deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Masat e tilla të ndërmarrura kanë ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e pyjeve që menaxhohen nga komuna.

Për mbajtjen në kontroll e gjendjes së pyjeve, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta: Komunë, Polici, Gjykatë dhe roje të pyllit, kemi organizuar takime të përbashkëta, me qëllim të ndikimit në pengimin e prerjeve ilegale të pyjeve.

Është bërë regjistrimi i dëmeve në terren sipas rajoneve, duke përjashtuar pjesën e Parkut Kombëtar "Sharri", që është kompetencë e MMPH.

Monitorimi i operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore

Shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menaxhimit, nga shitja ne cung (prerje sanitare) janë realizuar mjete në shumë prej **3,080.53 €**.

Janë kryer rrallime në Njësinë Menaxhuese “Uji i Bardhë”, në sipërfaqe prej **13.5 ha**.

Janë pranuar **190** kërkesa për prerje në pyjet private të cilat janë aprovuar, nga kërkesat e aprovuara janë vulosur **4327.91 m³** masë drusore për djegie për vitin 2019, të lejuar për prerje nga APK-ja. Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private janë realizuar **4065.27€**, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.